RAPORT
VJETOR 2016

Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

RAPORT VJETOR PËRMBLEDHËS – 2016

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje 4

1. DREJTORIA E PORTALIT QEVERITAR E-ALBANIA 6

1.1. Projekte të drejtorisë gjatë vitit 2016 6

1.1.1. Shtimi i 209 shërbimeve të reja për 18 institucione në portalin e-Albania sipas marrëveshjes me institucionet përfituese (faza 1) 6

1.1.2. Vendosje sportelesh dixhitale për portalin qeveritar e-Albania 7

1.1.3. Platforma Qeveritare e Ndërveprimit; riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G; zgjerimi me 21 shërbime të reja elektronike G2G, G2C, G2B dhe shtimi i 6 shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-Albania.al; version 1.0 Albania 8

1.1.4. Implementim i shërbimeve online për Ministrinë e Punëve të Jashtme 9

1.1.5. e-Ekzaminime (Sistemi i menaxhimit të radhës për ekzaminime të avancuara mjekësore) 10

1.1.6. Sistemi multifunksional i qendërzuar i lejeve të ndërtimit 11

1.1.7. Përmirëso Qytetin (Sistem i qendërzuar për 61 bashki) 12

1.2. Aktivitete promovuese (të renditura kronologjikisht) 13

1.3. Statistika të portalit qeveritar e-Albania 16

2. DREJTORIA E BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE 25

2.1. Sektori i i Regjistrimit dhe Standardeve të Databazave Shtetërore 26

2.2. Sektori i Auditimit të Databazave Shtetërore 30

2.3. Procesi i ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore 32

2.4. Plani i Auditimit për vitin 2017 33

2.5. Detyra të tjera 33

2.5.1 Dixhitalizimi 33

2.5.2 Plani për dokumentet shoqëruese të shërbimeve dhe shkëmbimin e tyre elektronikisht 35

2.5.3. Shqyrtimi i projekteve që kanë lidhje me bazat e të dhënave 36

2.5.4. Ndjekja e projekteve 36

3. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS 38

3.1. Sektori i Administrimit të Rrjetit Govnet 38

3.2. Sektori i Serverave dhe Infrastrukturës Mbështetëse të Sistemeve 44

4. DREJTORIA E SISTEMEVE e-GOV 48

4.1. Sektori i Menaxhimit të Sistemeve 48

4.1.1 Active Directory 48

4.1.2. Shërbimi i ofrimit të postës elektronike zyrtare për administratën publike 49

4.1.3. Komunikim tekst i menjëhershëm, video, zanor, chat, konferencë dhe web konferencë 50

4.1.4. Instalim automatik dhe qendror i aplikimeve 50

4.1.5. Licencimi i produkteve Microsoft 51

4.1.6. Project Server 51

4.1.7. e-Aktet (mbledhjet e qeverisë paperless) 52

4.1.8. EDRMS 53

4.2. Sektori i Programimit dhe Zhvillimit 53

4.2.1. Sistemi i monitorimit të shkallës së realizimit të angazhimeve të programit të qeverisë - NJMLP 54

4.2.2. Sistemi i menaxhimit dhe monitorimit të FZHR 54

4.2.3. eRaport 55

4.2.4. eQBZ 55

4.2.5. Menaxhimi i Aseteve të KM 55

4.2.6. Menaxhimi i Automjeteve 55

4.2.7. Menaxhimi i Ndjekjes së Kontratave 55

4.2.8. Menaxhimi i Hyrje Daljeve 55
4.2.9. IntraNet 56
5. DREJTORIA JURIDIKE DHE E STATISTIKAVE E-GOV & TIK 57
5.1. Sektori Juridik 57
5.2. Sektori Integrimit dhe Statistikave 57
5.3. Sektori Juridik 58
1.4. Sektori i Integrimit dhe Statistikave e-GOV dhe TIK 62
2. DREJTORIA E KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT e-GOV 65
6.1. Investime në fushën TIK për vitin 2016 65
6.1.1. Hartimi i Standardeve TIK 65
6.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekteve të TIK 65
6.2. Projektet kryesore të trajtuara nga AKSHI në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit 68
6.3. Projekte të AKSHI-t për vitin 2016 74
7. Drejtoria e Sigurisë e-Gov 76
7.1. Infrastruktura e Çelësit Publik, PKI 80
7.2. Platforma e Sistemit të Menaxhimit të Ngjarjeve 82
7.3. Siguria e faqeve të internetit të institucioneve zyrtare 83
7.4. Siguria e aksesit në internet të institucioneve 85
7.5. Siguria e postës elektronike zyrtare 85
7.6. Menaxhim dhe Optimizim i Trafikut në Internet, inspektim me imtësi të paketave (DPI) 86
7.7. Platforma e lëvrimit të aplikimeve 86
7.8. Firewall dhe VPN 86
7.9. Sistemi mbrojtës Antivirus i Qendërzuar 86
7.10. Aksesi Fizik në Qendrën e të Dhënave Qeveritare 87
8. DREJTORIA E VAZHDIMËSISË SË PUNËS BCC, Backup & DRC 88
8.1. Shërbimi i Data Recovery për Exadata (Projektet) dhe Infrastruktura Ekzistuese 88
8.2. Shërbimi i vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (back-up) për infrastukturat e sistemeve: 90
8.3. Dokumentimi i Procedurave për DRC dhe BCC 91
8.4. Aktivitete të tjera për vitin 2016 92
Lista e anekseve 93
Aneks 1.1: Infografik vjetor 2016 93
Aneks 1.2: Lista e shërbimeve elektronike deri në fund të vitit 2016 në portalin qeveritar e-Albania 95
Aneks 1.3: Lista e shërbimeve elektronike sipas projekteve 179
Aneks 1.4: Lista e institucioneve në GG 208

Përmbledhje

Në programin e Qeverisë është përcaktuar se Qeveria do të punojë në tre drejtime kryesore duke vendosur objektiva të matshme:

Së pari, për shtimin dhe promovimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës Open Government Partnership.

Së dyti, për përdorimin e TIK në edukim për të kapërcyer hendekun dixhital dhe për të aftësuar rininë. Politikat do të jenë të orientuara drejt përmirësimit dhe zgjerimit të kapaciteteve njerëzore në mënyrë që rritet numri i përdoruesve dhe të promovohet zhvillimi i ofruesve të e-shërbimeve. Në këtë mënyrë do të nxitet krijimi i vendeve të punës për të rinjtë, të cilët mund të punësohen në tregun shqiptar, rajonal e më gjerë.

Së treti, konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme.

"AXHENDA DIXHITALE E SHQIPËRISË 2015-2020"

Gjatë vitit 2016, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka realizuar:

Portali e-Albania u pasurua gjatë vitit 2016 me 217 shërbime të reja elektronike, duke e çuar në total numrin në 465 shërbime elektronike. Për 2016-n janë regjistruar 71.703 përdorues të rinj e gjithsej përllogariten 241 621 përdorues të regjistruar në portal; asistencë i është dhënë 5216 prej tyre. Numri i institucioneve të ndërlidhura në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit arriti në 42. Gjatë vitit 2016 pati rritje të numrit të transaksioneve të kryera në Platformë: Shifra 25.570.757 transaksione është dyfishuar në krahasim me vitin 2015. Përfundoi shpërndarja e 15 sporteleve dixhitale e-Albania në qytetet e mëdha të vendit.

Gjatë vitit 2016 janë trajtuar 181 praktika të institucioneve të Administratës Publike për projekte të reja, shtesa të projekteve ekzistuese, mirëmbajtje të sistemeve, si dhe përmirësim të infrastrukturave ekzistuese, 150 prej të cilave janë miratuar nga AKSHI, pa përfshirë këtu praktikat e tij. Janë regjistruar 45 projekte për zhvillime sistemesh të reja, 10 projekte të mirëmbajtjes dhe pajisjeve Hardware dhe 95 projekte për blerje pajisjesh Hardware.

Me qëllim ofrimin e shërbimeve me disponueshmëri të lartë dhe parandalimin e humbjes së të dhënave, AKSHI ka ofruar shërbimin e hostimit të infrastrukturave dytësore të sistemeve qeveritare, për vazhdueshmërinë e punës dhe rikuperimin nga fatkeqësia. Gjatë vitit 2016 kanë përfituar nga ky shërbim 6 institucione, duke e çuar në 17 numrin total të tyre, prej të cileve 11 ndodhen në ambientin virtual për rikuperimin nga fatkeqësia dhe vazhdueshmërisë së punës dhe 6 si infrastruktura fizike në Qendrën e të Dhënave Qeveritare.

Gjatë vitit 2016, Drejtoria e Sistemeve e-Gov ka realizuar ofrimin e postës elektronike zyrtare në administratën publike për 2407 përdorues të rinj; në Active Directory janë shtuar 1930 të tillë.

Gjithashtu janë licensuar 3550 produkte të Microsoft. Shërbimi Lync ka mundësuar komunikim tekst të menjëhershëm, video, zanor, chat, konferencë dhe web konferencë per 4005 përdorues. Përditësim i rregullt dhe i sigurt i 2083 makinave klientë dhe 207 makinave server nëpërmjet instalimit automatik dhe qendror të aplikimeve. Në Project Manager për planin operacional të Qeverisë janë shtuar 473 përdorues. Në sistemin EDRMS, Kryeministria ka përpunuar 610 shkresa, AKSHI ka përpunuar 669 shkresa ndërsa janë ngritur ambientet test për ministritë e linjës.

Gjatë vitit 2016, Sektori i Sigurisë mbrojti plotësisht portalin e-Albania nga 3.150.755 tentativa sulmesh kibernetike nëpërmjet sistemeve të saj të mbrojtjes, si dhe burimeve njerëzore. Sa i takon 309 faqeve zyrtare të cilat hostohen në serverët tanë, është regjistruar 1 sulm drejt faqes www.tirana.gov.al, i cili nuk arriti të realizohet plotësisht, pra mbeti thjesht si një incident pa rezultat pozitiv. Me sukses është realizuar edhe bashkëpunimi në kuadër të projektit e-leje, pasi AKSHI-i si Ofrues i Kualifikuar i Shërbimeve të Besuara (OKSHB), realizoi pjesën e nënshkrimit elektronik. Në total janë pajisur me nënshkrim elektronik 1700 aktorë, 1000 prej të cilëve janë të administratës publike dhe 700 të subjekteve private.

Gjatë vitit 2016, Drejtoria e Infrastrukturës e-Gov ka kryer upgrade të: Core (Data Center); rrjetit të Distribucionit dhe Aksesit; DIS servers; PKI Site; e-Albania, Production dhe TEST; Optimizim të rrjetit MPLS; IOS dhe firmware për Cisco dhe Fortinet; firmware-t për Firewall-et Checkpoint; rrjetit akses për Public Cloud; firmware dhe drivers nyjet e "Public dhe Private Cloud" ; kapaciteteve Storage per "Public dhe Private Cloud". Gjithashtu janë lidhur me fibër optike 5 institucione të reja, dhe transferuar 4 institucione, 71 hostime të reja për institucione, 43 zona të reja në DNS Publike për Domain-et e institucioneve, implementimi i Platformës Heterogjene, implementimi i Arkivës Elektronike, zgjerimi i "Private Cloud" me 2 (dy) nyje te tjera, transferimi i sistemeve back-end i institucioneve në Data Center-in e AKSHI-t.

Gjatë vitit 2016 ka vazhduar puna për identifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin e bazave të të dhënave shtetërore. Deri tani janë regjistruar gjithsej **36** Baza të Dhënash Shtetërore, nga **26** të tilla në vitin 2015. Po vijon plani për dokumentet shoqëruese të shërbimeve dhe shkëmbimin e tyre elektronikisht.

1. DREJTORIA E PORTALIT QEVERITAR E-ALBANIA

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 703, datë 29.10.2014, "Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit":
pika 2. AKSHI ka objekt të veprimtarisë:
a) ofrimin e shërbimeve të përqendruara online për qytetarët përmes Teknologjisë së Informacionit e Komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike;
pika 3, AKSHI ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:
dh) Zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike, e cila përbëhet nga:
- Portali unik qeveritar e-albania.al, platforma qeveritare e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, sipas tipologjisë: qeveri-qeveri, qeveri-qytetar, qeveri-biznes;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 734 datë 28.08.2013 "Për Krijimin e Sistemit Unik të Regjistrimit, Autentifikimit dhe Identifikimit të Përdoruesve në Marrjen e Shërbimeve";
- Specifikime Teknike "Sistemi i Ndërveprimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore";
- Specifikime Teknike "ESB – Government Gateway dhe Government Payment Gateway";
- Korniza Kombëtare e Ndërveprimit.

Për sa më sipër, Drejtoria e Portalit Qeveritar e-Albania ka si objektiv të saj administrimin e portalit qeveritar e-Albania, për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, sipas tipologjisë: qeveri – qeveri, qeveri – qytetar, qeveri – biznes.

1.1. Projekte të drejtorisë gjatë vitit 2016

Gjatë vitit 2016, janë realizuar projektet e listuara më poshtë:

1.1.1. Shtimi i 209 shërbimeve të reja për 18 institucione në portalin e-Albania sipas marrëveshjes me institucionet përfituese (faza 1)

Me anë të këtij projekti është synuar ndërtimi i një Sistemi Menaxhimi Formash Elektronike (eForms) që ka patur si qëllim zhvillimin e një projekti për hartimin elektronik, dërgimin e kërkesave për e-shërbime nga qytetarët me anë të formularëve (eForms) nga portali qeveritar e-Albania drejt institucioneve ofruese të shërbimit. Përmes këtij projekti do të shtohen 209 shërbime të reja elektronike për 18 institucione. Implementimi i këtij projekti ka rëndësi dhe ndjeshmëri të lartë pasi ndihmon institucionet e përfshira për të zvogëluar punën manuale me letra, që është më e ngadaltë sesa përpunimi elektronik i informacionit duke përdorur forma elektronike për komunikim me qytetarët si dhe do të ndihmojë këto të fundit dhe biznesin për të zvogëluar kohën e marrjes së shërbimeve. Ndër komponentët që me implementimin e këtij projekti synohen të arrihen janë: përmirësimi dhe modernizimi i shërbimeve publike si dhe rritja e performancës së institucioneve në nivel qendror dhe vendor.

Gjatë vitit 2016 janë publikuar në portalin qeveritar e-albania 115 shërbime elektronike të nivelit 3 dhe 4, prej së cilave 52 shërbime elektronike të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe

63 shërbime elektronike të Qendrës Kombëtare të Biznesit (aplikime për liçenca). Po punohet për analizat e shërbimeve të mbetura të cilat janë drejt përfundimit. Është ngritur infrastruktura e nevojshme e form serverit dhe është realizuar implementimi i tij.

Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ofrojnë një gamë prej 52 shërbimesh që lidhen me të gjitha kategoritë e pronës së paluajtshme. Ato nisin që nga më të rëndësishmet që janë regjistrimet e çdo lloji, e deri te korrigjimet e ndryshme apo kopje hartash.

Dixhitalizimi i të 52 shërbimeve që ofrohen nga ZRPP-ja, bashkë me dixhitalizimin në proces të regjistrave të pasurive të paluajtshme është një ndërhyrje themelore në atë që qeveria e ka quajtur reformë në shërbimet publike. Portali i ka dhënë rëndësinë e duhur kësaj kategorie, duke krijuar në faqen kryesore të tij rubrikën e posaçme e-prona, që ndërfaqëson për të gjithë të interesuarit shërbimet që kanë të bëjnë me pasurinë e paluajtshme. Të gjitha procedurat që janë aktive kërkojnë regjistrim dhe identifikimin e përdoruesit, çka do të thotë se çdo veprim lë gjurmë në sistem duke krijuar në këtë mënyrë garanci juridike për qytetarët se problemi i deridjeshëm i ndërmjetësimit të shërbimit zyrtar përmes sekserëve të eliminohet përfundimisht. Aplikimi përmes portalit është formalisht dhe praktikisht protokollim automatik i aplikimit që lë gjurmë unike në sistem dhe ai detyron njoftimin e aplikuesit në rrugë elektronike, e-mail, apo në hapësirën e posaçme personale në portal, për statusin zyrtar të aplikimit të tij,

Të gjitha shërbimet shoqërohen me suportin teknik online (live chat) që i ndihmon aplikuesit të sqarojnë çdo paqartësi proceduriale, ndërkohë që disponibiliteti i portalit me 99% të funksionalitetit 24/7, jep mundësi që faza e parë e procedurave që lidhen me pasurinë e paluajtshme, aplikimi/kërkesa për shërbimet nga ZRPP-ja të kryhet në çdo kohë dhe ngado. Ky është një aspekt i rëndësishëm, pasi siç dihet shërbimet e ZRPP-së në sportelet tradicionale ofrohen në përputhje me ndarjen administrative, që do të thotë se në masë të madhe rastesh, finalizimi i aplikimit detyronte qytetarët të paraqiteshin në sportele jashtë vendbanimit të tyre.

Shërbimet e-prona japin mundësi që përmes transaksioneve online në portalin e-albania, të krijojnë një bazë të dhënash dinamike të kërkesave dhe përpunimit të tyre duke ndihmuar shumë në sqarimin e problemeve të krijuara, si mbivendosjet, kufijtë, trashëgiminë, legalizimet, të gjitha elementet që në përfundim çojnë në rivlerësimin e pronës dhe sigurinë e qytetarëve për të.

Nga ana tjetër, dixhitalizimi i shërbimeve për aplikimin për 63 liçenca në Qendrën Kombëtare të Bizneseve, i vjen në ndihmë subjekteve të interesuara në ushtrimin e akitivitetit. Ai vë në veprim praktikën e re të aplikimit online me dokumente të nënshkruara elektronikisht duke ofruar shërbime PaperLess, për dixhitalizimin e plotë të shërbimeve publike.

Po kështu aplikimi përmes portalit e-albania mundëson shërbim të thjeshtuar dhe të shpejtë, me një sportel për biznesin teksa përpunimi i tij, statusi dhe përgjigja bëhen me dije në rrugë elektronike.

1.1.2. Vendosje sportelesh dixhitale për portalin qeveritar e-Albania

Objektivi i këtij projekti ishte vendosja e 15 sporteleve dixhitale në pikat më kryesore të vendit si pika të aksesit publik që ofrojnë hyrje të lirë dhe të besueshme për të gjithë në internet, brandimi i

sporteleve dixhitale me logon e portalit unik qeveritar e-Albania dhe shoqërimi i instalimit të tyre në pikat e caktuara me ngjarje promovuese. Nëpërmjet shpërndarjes së sporteleve dixhitale, portali unik qeveritar e-Albania synon të ofrojë akses dhe kërkim më të lehtë në internet për qytetarët apo grupet e tjera të interesuara, të cilët mund të drejtohen në një pikë të vetme aksesi publik për të marrë informacion apo shërbimet publike online që ofrohen nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania. Sporteli dixhital i shërbimeve publike ofron nëpërmjet automatit shërbime publike 24/7.

Nëpërmjet sportelit dixhital qytetarët dhe bizneset mund të kryejnë aplikime, pagesa faturash, të marrin certifikata, vërtetime online dhe një sërë shërbimesh të tjera. Sportelet dixhitale janë të pajisura me ekran me prekje, lexues karte për kartën e identitetit, lexues karte krediti/debiti duke u dhënë mundësi përdoruesve të kryejnë edhe pagesa; printer ku mund të printohen vërtetime e certifikata të ndryshme apo faturat për pagesat e kryera.

Gjatë vitit 2016 përfundoi me sukses shpërndarja e 15 sporteleve dixhitale (një sportel dixhital në secilin institucion) në pikat si më poshtë:

1. Bashkia Tiranë
2. Bashkia Shkodër
3. Bashkia Korçë
4. Bashkia Vlorë
5. Bashkia Malësi e Madhe
6. Bashkia Elbasan
7. Elkos Trading Center Fier
8. ADISA Tiranë (sportelet e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme)
9. DPSHTRR Tiranë
10. QKB Tiranë
11. FSDKSH Tiranë
12. Bashkia Sarandë
13. FlagShip Center Durrës
14. Adisa Fier (dorëzimi do të bëhet sapo të hapet qendra)
15. Adisa Kavajë

1.1.3. Platforma Qeveritare e Ndërveprimit; riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G; zgjerimi me 21 shërbime të reja elektronike G2G, G2C, G2B dhe shtimi i 6 shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-Albania.al; version 1.0 Albania

Qëllimi i kontratës me objekt “Lidhje sistemesh në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit dhe shtimi i shërbimeve të reja për vitin 2015” ishte integrimi i sistemeve të ndryshme qeveritare në Platformën e Ndërveprimit ESB. Si rezultat i këtyre integrimeve, portali e-Albania eshte pasuruar me shërbime të reja elektronike, duke përditësuar edhe shërbimet elektronike ekzistuese.

Gjatë vitit 2016, kontrata është realizuar konkretisht me:

- Blerje të 11 nyjeve ndërlidhëse (DIS) të reja dhe konfigurim të 15 nyjeve ndërlidhëse (DIS), duke e zgjeruar listën e institucioneve publike të integruara në ESB;
- Riinxhinierim e modernizim procesesh pune të sistemeve të reja që do të lidhen dhe atyre ekzistuese (në total 15 institucione);
- Ofrim shërbimesh të reja elektronike në portalin qeveritar e-Albania;
- Ngritje të infrastrukturës mbështetëse të DIS dhe integrim të saj në rrjetin qeveritar GOV-NET;
- Komunikim të çdo DIS me ESB dhe me institucionin përkatës (të cilit ky DIS i përket);
- Konfigurime të DIS-eve të reja apo modifikime të konfigurimeve ekzistuese për të akomoduar shërbimet elektronike që do të shtohen, do të mbulohen nga ky projekt;
- Janë shtuar sisteme monitorimi për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe aplikimit të DIS-eve dhe Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.
- Implementimi i kontratës është realizuar me 6 shërbime elektronike në portalin qeveritar e-Albania dhe 46 shërbime ndërveprimi G2G në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit.

1.1.4. Implementim i shërbimeve online për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Objektivi i përgjithshëm i projektit të "Implementimit të shërbimeve online për Ministrinë e Punëve të Jashtme" ishte publikimi dhe dixhitalizimi i të 36 shërbimeve të ofruara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Përfaqësia Diplomatike dhe Konsullore në portalin e shërbimeve unike qeveritare e-albania.al. Projekti kishte si objektiv gjithashtu përshtatjen e faqeve të internetit të çdo konsullatë me elementet: trokitje virtuale, tur virtual në 3D për çdo konsullatë dhe orientimin e vizitorëve të faqeve në paketën e shërbimeve.

Implementimi i projektit ka përfunduar me sukses brenda vitit 2016, duke arritur:

- Publikimin e 36 shërbimeve elektronike në portalin qeveritar e-Albania.
- Përshtatje e faqeve të internetit të çdo konsullatë me elementët: trokitje virtuale, tur virtual në 3D për çdo konsullatë dhe orientimin e vizitorëve të faqeve në paketën e shërbimeve.

Shërbimet elektronike që janë tanimë aktive përmes portalit e-albania, japin përgjigjen optimale për kërkesat përherë e më të mëdha në adresë të zyrave konsullore shqiptare. Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare numërohen në 50 dhe ato janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të 1.400.000 emigrantëve shqiptarë, të cilat në vetvete përfshijnë përpunim dokumentacioni dhe shqyrtim aplikimesh përherë e më shumë në rritje. Shërbimet konsullore dixhitale si standard i prezantuar rishtas, rregullojnë raportin mes fluksit të kërkesave dhe domosdoshmërisë së garantimit të veprimeve të sigurta, të shpejta dhe pa nevojën e paraqitjes fizike në selitë konsullore për pjesën më të madhe të shërbimeve. Ky ka qenë edhe një nga problemet më të mëdha, me kosto për emigrantin shqiptar që tashmë ka mundësi të kryejë aplikimet në çdo kohë dhe nga çdo pikë aksesimi në internet.

Po kështu, duke u fokusuar te përdoruesi që fiton të drejta mbi sistemin e ri që mundëson kryerjen e aplikimeve, krijohen kushtet që dukuritë e korrupsionit të goditen në burim, meqenëse tanimë raporti mes aplikuesit dhe ofruesit të shërbimit kalon në një proçes që lë detyrimisht gjurmë. Në tërësinë e

vet këto elementë japin një zgjidhje maksimale edhe për kostot e mëdha dypalëshe; kërkuesit të shërbimit, por edhe ofruesit të tij.

1.1.5. e-Ekzaminime (Sistemi i menaxhimit të radhës për ekzaminime të avancuara mjekësore)

Qëllimi i sistemit të e-ekzaminimeve është rezervimi dhe regjistrimi online nga shtetasit për ekzaminimet e avancuara mjekësore. Sistemi ofron mundësinë e ndërveprimit të mjekëve (mjekut të familjes, mjekut specialist, mjekut që kryen ekzaminimin). Në sajë të sistemit është dixhitalizuar procesi i menaxhimit dhe rezervimit të ekzaminimeve të avancuara mjekësore (në sistem ruhen të gjitha të dhënat e mëposhtme: rekomandimi i mjekut të familjes, referenca e mjekut specialist, rezervimi i ekzaminimit të avancuar mjekësor, përgjigjja e mjekut të ekzaminimit dhe interpretimi i rezultatit të mjekut specialist).

Gjatë vitit 2016 ka përfunduar brenda afateve të përcaktuara të kontratës zhvillimi dhe testimi i sistemit të e-ekzaminimeve, i cili do të administrohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe do të bëjë të mundur rezervimin online nga shtetasit për ekzaminimet e avancuara mjekësore.

Gjithashtu janë publikuar në portalin e-albania në muajin dhjetor 34 shërbime elektronike që mundësojnë rezervimin e radhës për ekzaminimet e avancuara mjekësore, konsultimin online të rekomandimeve të marra nga mjeku dhe mundësinë e ngarkimit të një rekomandimi të skanuar, për të bërë më pas rezervimin e radhës në bazë të këtij rekomandimi (në rastet kur rekomandimi nuk është ngarkuar nga mjeku).

Sistemi i ri parashikohet të ketë ndikim në disa drejtime konkrete. Së pari ai plotëson standardin e sjellë nga dy shërbime të tjera parësore që janë aktive në portalin e-albania: shërbimi për Kartën e Shëndetit dhe ai për Kontrollin Mjekësor Bazë. Në vetvete ato japin një kontribut thelbësor për regjistrin shëndetësor të popullatës, që është statistikë interaktive shumë e rëndësishme, ndërkohë që e-ekzaminimet e pasurojnë më tej atë, duke edukuar gradualisht popullsinë me një kulturë të re të kërkimit të shërbimeve në këtë drejtim.

Përfitimet nga zbatimi i projekti janë praktike; ato adresojnë disa nga problemet kronike të shërbimit mjekësor të nivelit të dytë e të tretë.

Përmes implementimit të këtij sistemi pritet:

- Rritja e aksesit dhe transparencës me shtetasit për rezervim online të ekzaminimeve me pajisje mjekësore;
- Ulje e kohës së përgjigjes ndaj shtetasve për datën e caktimin të marrjes së ekzaminimit të avancuar me pajisje mjekësore;
- Caktimin online të institucionit shëndetësor në të cilin do të kryhet ekzaminimi i avancuar shëndetësor duke i caktuar pacientit një numër radhe virtuale;
- Menaxhim më të mirë dhe të kontrolluar të kohës së stafit mjekësor për kryerjen e këtyre ekzaminimeve të avancuara;
- Ulje e radhëve të pritjes së shtetasve për të tilla ekzaminime;

- Komunikim me "sms gateway" që ka AKSHI për të njoftuar shtetasit (me sms) për datën e caktuar të ekzaminimit;
- Krijimi i versionit mobile application për e-ekzaminimet dhe mundësimin e aksesimit nga pajisje mobile dhe telefonë inteligjente.

Projekti pra transformon mënyrën e kërkimit të shërbimeve nga qytetarët dhe për rrjedhojë edhe dhënien e tij në mënyrë më cilësore dhe programuar nga sistemi shëndetësor.

1.1.6. Sistemi multifunksional i qendërzuar i lejeve të ndërtimit

Objektivi kryesor i këtij projekti është ndërtimi i një sistemi multifunksional dhe të qendërzuar për të lehtësuar procedurat e aplikimeve për leje zhvillimi dhe ndërtimi, duke iu dhënë mundësinë qytetarëve dhe bizneseve të aplikojnë online. Duke qenë një sistem i qendërzuar, synohet që të aksesohet në mënyrë elektronike nga 61 NJQV-të dhe të gjithë institucionet e tjera të përfshira në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet llogarive përkatëse. Gjithashtu, ky projekt synon edhe realizimin e komunikimit elektronik të regjistrit të AKPT-së me regjistrat elektronike të institucioneve të tjera për verifikime apo marrje automatike të të dhënave të aplikantëve, nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, si dhe gjurmimin e statusit të aplikimit në çdo fazë të tij, nëpërmjet sistemit e-Tracking. Synohet gjithashtu përshtatja e Regjistrit aktual Elektronik në përputhje me ndryshimet me të fundit ligjore, si dhe përmirësimi i funksionaliteteve aktuale të Regjistrit Elektronik dhe sistemit GIS.

Prej **1 shtatorit 2016** çdo qytetar apo biznes që kërkon të përfitojë leje ndërtimi, duhet të aplikojë online përmes portalit qeveritar e-Albania.

Shërbimi e-lejet ofron një gamë prej 19 aplikimesh që lidhen me sektorin e ndërtimit apo me ndërhyrjet në banesa private. Sistemi e ka provuar veten efektiv dhe disa statistika të këtyre muajve janë një ilustrim për këtë. Shërbimi e-lejet është përdorur mbi 23 000 herë deri në datën 31 dhjetor 2015 dhe regjistron mbi 1200 aplikime të dërguara.

Nga numri i përgjithshëm i aplikimeve të të gjitha llojeve, shpërndarja gjeografike paraqitet si më poshtë:

- Tiranë 34.6%
- Durrës 11.9%
- Vlorë 5.58%
- Shkodër 5.4%
- Korçë 5.58%
- Krujë 3.72%
- Fier 4.74%
- Lushnjë 1.97%
- Gjirokastër 1.97%

Një tregues me rëndësi është edhe se cili është aplikimi më i madh numerikisht, që shërben edhe si tregues tregu. Nga të dhënat që disponon portali unik qeveritar e-albania, rezulton se kërkesa kryesore e depozituar përmes shërbimeve e-lejet është:

"Deklarata Paraprake e fillimit të Punimeve" që zë: 33.01% të kërkesave. Më poshtë tri shërbimet e tjera për të cilat është aplikuar më shumë janë:

- Leje zhvillimi 26.7%
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 7.2%
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m2 5.47%

Koha mesatare e përgjigjes për aplikimet është shkurtuar:

30-60 ditë për lejet, duke patur parasysh se shërbimi i ri jep përgjigje finale pasi ka rakorduar veprimet me të gjitha institucionet përgjegjëse dhe vetëm 5 ditë (nga momenti i aplikimit) për deklaratat paraprake. Theksojmë se përgjigja vjen në rrugë elektronike për aplikuesit. Një tregues tjetër që flet për volumin e punës që qëndron pas shërbimit është raporti i përgjigjeve negative me pozitive:

Nga numri total rezulton se 22.8% janë miratuar, 42.04% janë refuzuar, kurse pjesa tjetër është në shqyrtim.

Sistemi elektronik i lejeve u ndërtua nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për llogari të dy agjencive në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Urban, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT). Sistemi, i cili ka dy module: planifikimin dhe aplikimin, ka integruar 61 bashki dhe AZHT-në për pjesën e aplikimeve online, do të bëjë të mundur realizimin e shërbimit me një ndalesë për lejet e ndërtimit.

Procedura eviton paraqitjen e vërtetimeve nga institucionet e përfshira dhe e gjitha është paracaktuar që të kryhet brenda afateve të qarta dhe pa vonesa.

Institucionet e integruara në sistemin janë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Qendra Kombëtare e Biznesit (Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Qendra Kombëtare e Licencimit) dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ndërsa me statusin e institucioneve 'për mendim' janë 9 të tjera si ALUIZNI, Instituti i Monumenteve të Kultures, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura etj.

1.1.7. Përmirëso Qytetin (Sistem i qendërzuar për 61 bashki)

Sistemi shërben si një dritare e komunikimit efektiv online mes qytetarëve dhe bashkive respektive. Objektivi i këtij investimi është të përmirësojë mënyrën e raportimit me anë të kërkesave, ankesave dhe sugjerimeve të qytetarëve drejtuar qeverisjes vendore, krijimin e një sistemi të qendërzuar, pa pagesë, me baza të dhënash sipas kategorive të bëra nga raportimet; përmirësimin e komunikimit midis administratës dhe qytetarit në një kohë reale duke rritur standardin e ofrimit të shërbimeve, rritjen e përgjegjësisë dhe shtimin e transparencës në vendimmarrje, minimizimin e rasteve të lëna pezull duke ofruar një zgjidhje sa më të shpejtë. Sistemi ofrohet ne versionin web dhe mobile për Android dhe për iOS. Sistemi është përfunduar në maj të vitit 2016 dhe është në fazën e mirëmbajtjes.

Aneks 1.3 për më shumë informacion mbi listën e shërbimeve sipas projekteve të sipërpëmendura.

1.2. Aktivitete promovuese (të renditura kronologjikisht)

2. **Janar: Aplikacioni i ri i e-Albanias për iOS. Informim tek e-Albania dhe në rrjete sociale për përdoruesit e portalit.**

Aplikacioni shfaq në format të përshtatur për pajisjet mobile, të gjitha shërbimet e portalit, si edhe funksionet e tjera të tij si lajmet, foto e video galeritë, ndryshimi i të dhënave personale, konsultimi i shërbimeve të përdorura më parë, etj. Një avantazh i aplikacionit mobile është dërgimi i njoftimeve (push notifications) për të lajmëruar përdoruesit për shërbime të reja apo lajmërime të tjera të rëndësishme.

3. **Shkurt: Promovim në portalin e-Albania dhe në rrjete sociale për shërbimet lidhur me Kartën e Shëndetit.**

Informatizimi i shërbimeve që lidhen me Kartën e Shëndetit bën të mundur lidhjen dhe marrjen në kohë reale të informacionit në disa institucione njëherësh, regjistrin e Gjendjes Civile, regjistrin e pensioneve, regjistrin e kontribuesve; regjistrin e punëkërkuesve, si dhe regjistrin e ndihmës ekonomike. Për qytetarët, kjo eliminon një radhë dokumentesh. Lidhur me këto shërbime, veç informacionit promovues në portalin e-Albania është kryer edhe një minifushatë informuese në rrjete sociale.

4. ***Mars:* Promovim për vendosjen e një sporteli dixhital në Bashkinë Korçë, me rastin e hapjes së zyrës me një ndalesë për shërbime ndaj qytetarëve.**

Me asistencën e USAID-it dhe Institutit të Politikave Publike dhe Private u bë e mundur krijimi i Zyrës së Shërbimeve Administrative me një ndalesë në Bashkinë Korçë dhe në 7 Njësitë Administrative të saj. Sistemi elektronik, i cili mbështet shërbimet e ofruara të zyrës me një ndalesë, është ndërtuar në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe hostohet në Qendrën Qeveritare të të Dhënave.

5. ***Prill:***

a) **Aktivitet promovues në Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe të së Drejtës së Autorit në ambientet e Bibliotekës Kombëtare**.

Me rastin e 23 prillit, Ditës Ndërkombëtare të Librit dhe të të Drejtës së Autorit, Drejtoria e Portalit e-Albania organizoi një aktivitet në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, në bashkëpunim me këtë institucion të rëndësishëm të jetës kulturore në vend. Gjatë aktivitetit u prezantua në tërësi portali qeveritar, avantazhet e përdorimit të tij dhe shërbimet e reja.

b) Albanian ICT Awards 2016: e-Albania, "Shërbimi publik më i mirë i vitit"

AKSHI me projektin e-Albania u shpall në prill të 2016 nga 'Albanian ICT Awards' si 'Shërbimi Publik më i mirë i vitit'. Kjo arritje u pasqyrua në portalin e-Albania, ne faqen zyrtare te AKSHI-t, http://akshi.gov.al/, si dhe në rrjete sociale.

6. ***Maj:***

a) **Fushatë promovuese në gjimnaze dhe universitete të Tiranës**

Drejtoria e Portalit Qeveritar e-Albania zhvilloi përgjatë muajit maj, një fushatë promovuese në shkolla të mesme dhe universitete të Tiranës, me synim njohjen e të rinjve me shërbimet kryesore të portalit dhe me rritjen e ndërgjegjësimit për dobitë që vijnë nga përdorimi i tij.

b) Pjesëmarrje e e AKSHI-t në konferencën e parë rajonale "Digital Agenda Day"

Në kuadër të Javës së Inovacionit u zhvillua më 18 maj 2016 konferenca e parë rajonale "Digital Agenda Day 2016", me temën "Inovacion për Mirëqeverisje", ku ishin të pranishëm përfaqësues të lartë të shtetit, specialistë, dhe drejtues të bizneseve e korporatave të sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Gjatë punimeve të konferencës u prezantua puna e AKSHI-t. Gjithashtu u vu theksi tek aktiviteti intensiv që po kryhet me portalin unik e-Albania, ndërveprimin institucional dhe dobitë që sjell përdorimi i shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe punonjësit e administratës publike.

7. **Qershor: Promovim i shërbimeve kryesore të e-Albanias me të rinjtë në një takim të organizuar në Godinën e Inovacionit**

Në ambientet e 'Innovation Hub' më datë 21 qershor 2016 u zhvillua aktiviteti "NGO Connection Day/Technology for Good", organizuar nga "Microsoft Albania" dhe "Protik". Në aktivitetin ku ishin të pranishëm të rinj nga organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit folën rreth projektit më të rëndësishëm qeveritar online e-Albania, portën unike në internet prej nga ku qytetarë, biznese dhe punonjës të administratës publike marrin mbi 800 shërbime elektronike dhe informative.

8. **Gusht: Çelja e edicionit të Dytë të Konkursit të Turizmit**

Portali unik qeveritar e-Albania organizoi për të dytin vit radhazi konkursin mbarëshqiptar të turizmit. Pranimi i aplikimeve nisi në muajin gusht, e paracaktuar si një fazë e parë kjo, për t'u ndjekur më pas nga faza e votimit të aplikimeve deri në shpalljen e fituesit më 27 shtator, Ditën Ndërkombëtare dedikuar Turizmit.

Në mënyrë të organizuar, pas pranimit të aplikimeve është kryer edhe një fushatë promovuese në rrjete sociale, me qëllim informimin për realizimin e Konkursit, tematikën e tij, datat se kur pranohen aplikimet konkurruese, mënyra e votimit, ftesa që i bëhet përdoruesve të paregjistruar për të kryer procesin e regjistrimit, kusht i domosdoshëm si për dërgimin e aplikimeve ashtu edhe për votimin e tyre në fazën e dytë.

9. **Shtator:**

a) Pjesëmarrje dhe asistencë në prezantimin e sistemit multifunksional të lejeve të ndërtimit, promovim në portalet respektive: akshi.gov.al dhe e-Albania të aktivitetit realizuar me këtë rast, si dhe shpërndarje të spotit në rrjete sociale për informimin e publikut lidhur me këtë projekt të ri që ndodhet në portalin e-Albania, menaxhuar dhe administruar nga AKSHI.

b) Çelja e fazës votuese në Konkursin e Turizmit 2, informim nëpërmjet portaleve e-Albania dhe akshi.gov.al, si dhe promovim nëpër rrjetet sociale të aplikimeve të mbërritura, ftesës për t'i

votuar ato dhe orientimit se procedurat kryhen vetëm nëse përdoruesit është i regjistruar në portalin e-Albania.

c) Shpallja e fituesve të Konkursit të Turizmit 2 më 27 shtator 2016, në sallën e "Innovation Hub" pranë Godinës së Inovacionit.

10. Tetor:

a) Trajnime me mësuesit e TIK në mbarë vendin

Përgjatë gjysmës së parë të muajit tetor të vitit 2016, punonjës të Drejtorisë së Portalit Qeveritar e-Albania zhvilluan një sërë trajnimesh në 13 drejtoritë arsimore rajonale në mbarë vendin me mësuesit e lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Në lëndën e TIK-ut të klasës së 10-të, sipas kurrikulave të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, është parashikuar trajtimi i temës 'Portalet dixhitale'. e-Albania, me gamën e madhe të shërbimeve elektronike dhe informative që ofron, është shembulli më i mirë lidhur me portalet dixhitale, ndaj këto trajnime i shërbyen mësuesve të marrin njohuritë e duhura në përmbajtjen dhe përdorimin e tij, me qëllim informimin e saktë të nxënësve dhe parapërgatitjen e tyre për përdorimin e shërbimit “Matura Shtetërore”. Ky shërbim është rruga kryesore që duhet të ndjekin maturantët për të aplikuar për formularët A1 dhe A1Z.

Gjithashtu në komunikimin e drejtpërdrejtë me mësuesit e lëndës së TIK-ut, punonjësit e drejtorisë pasi përshkruan me detaje përmbajtjen e portalit, sollën edhe shembuj konkretë të përdorimit të pjesës më të madhe të shërbimeve elektronike që vijnë në ndihmë të qytetarit dhe biznesit.

Trajnimet e mbështetura nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) u zhvilluan me 332 mësues të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Tiranës, Durrësit, Fierit, Korçës, Shkodrës, Elbasanit, Vlorës, Lezhës, Peshkopisë, Kukësit, Beratit, Dibrës dhe Gjirokastrës.

b) Aktiviteti “World Cities Day”

Për të dytin vit radhazi Drejtoria e Portalit Qeveritar e-Albania, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit organizoi një aktivitet në godinën "Liria", pranë Universitetit të Tiranës në kuadër të 31 tetorit, Ditës Ndërkombëtare të Qyteteve, me pjesëmarrjen e dhjetëra studentëve të degës Informatikë-Ekonomike. Në aktivitet u theksua rëndësia e kësaj dite, si në evokimin e arritjeve të deritanishme sa i takon zgjidhjeve inteligjente në vendin tonë, ashtu në nxitjen e të rinjve për t'i përqafuar ato në jetën e përditshme.

11. Nëntor: Takim promovues me qytetarë pranë ambienteve të DRSHTRR-së së kryeqytetit

Specialistët e Drejtorisë së Promovimit të portalit qeveritar e-Abania zhvilluan më datë 9 nëntor 2016, një aktivitet promovues me qytetarë të pranishëm pranë sporteleve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor në Tiranë, në kuadër të fushatës promovuese në terren për sportelet dixhitale të shpërndara në 15 pika të ndryshme në mbarë vendin. Në kontaktet me qytetarët u dhanë shpjegime të hollësishme mbi shërbimet e sportelit dixhital e-Albania dhe mbi funksionalitetet e tij si dhe u shpërndanë fletëpalosje informuese.

12. Dhjetor

a) Aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Antikorrupsionit

Me rastin e 9 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare Antikorrupsion, Drejtoria e Portalit qeveritar e-Albania, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) zhvilloi një aktivitet në sheshin "Vëllezërit Frashëri", në Tiranë, me moton kryesore kushtuar kësaj date: "Të bashkuar kundër korrupsionit".

Në shesh u vendosën dy sportele dixhitale e-Albania, prej të cilave qytetarët mund të përdorin shërbimet për të cilat janë të interesuar, një 'banner' me logon e portalit, si dhe u shpërndanë fletëpalosje informuese për kalimtarët. Nuk mungoi interesi për përdorueshmërinë e sporteleve, ndërsa specialistët e Sektorit të Promovimit orientuan përdoruesit që ta përdorin portalin nëpërmjet çdo pajisje elektronike që disponojnë, me qëllim marrjen e shërbimeve kur dhe ku të duan ata vetë.

b) Fushatë promovuese e e-Albanias në portalet online shqiptare, me vlerë 796.000 lekë pa TVSH

Qëllimi i kësaj fushate ishte promovimi i portalit unik qeveritar e-Albania dhe shërbimeve të tij te lexuesit e portaleve shqiptare online. Pjesa kyçe e fushatës në portalet online ishte krijimi i një sistemi reklamimi online i cili mundësoi menaxhimin e te gjitha reklamave dhe ruajtjen e statistikave të shfaqjes së banner-ave, si dhe klikimet që janë gjeneruar nga një banner i caktuar. Në përfundim të fushatës u arritën mbi 20 milionë impressions të banner-it në 9 portalet online shqiptare ku ai u reklamua.

13. <u>Janar – dhjetor: Promovim i vazhdueshëm në rrjetet sociale, mediat vizive dhe nëpërmjet ditarit elektronik (newsletter)</u>

Paralelisht me aktivitetet promovuese të pasqyruara, specialistët e Drejtorisë së Portalit e-Albania kanë përçuar vazhdimisht në median vizive risitë, lehtësirat dhe mundësitë që ofrohen për qytetarët e bizneset në e-Albania. Në rrjetet sociale janë publikuar infografikë, postera dhe video mbi shërbimet në portal.

Gjithashtu, periodikisht është kryer dërgimi nëpërmjet e-mail-it i ditarit elektronik (newsletter) i portalit e-Albania. Qëllimi i tij është informimi dhe nxitja përdorimit të shërbimeve elektronike ekzistuese dhe ato të reja në portal, informimi mbi aktivitete të organizuara nga AKSHI, informimi mbi nisma të ndërmarra nga qeveria në kuadër të dixhitalizimit dhe përmirësimit të infrastrukturës dixhitale të shërbimeve që ofrojnë institucionet e administratës publike, infografikë informues etj.

1.3. Statistika të portalit qeveritar e-Albania

Pageviews (klikime në faqen e portalit dhe nënfaqeve të tij): 5,300,922 për vitin 2016 **(Aneks 1.1)**

Në **Grafikun 1** jepen përdoruesit e portalit e-Albania të grupuar sipas moshës



Grafku 1 *Përdoruesit sipas grupmoshës*

Grafiku 2 na jep informacion mbi përqindjen e përdoruesve të portalit qeveritar e-Albania sipas gjinisë, ku shihet qartë se përqindje më të madhe e zënë meshkujt me 54,15% kundrejt 45,85% femra.



Grafik 2 *Përqindja e përdoruesve të portalit qeveritar e-Albania sipas gjinisë*

Në vijim kemi **Grafikun 3** mbi sjelljen e vizitorëve në bazë të sesioneve të gjeneruara prej tyre. Një sesion nënkupton numrin e herëve që përdoruesi ka hyrë në portal (me termin "hyrje në portal" nënkuptohet jo domosdoshmërisht logimi në portal, por edhe thjesht klikimi i njërës prej faqeve të portalit pa qenë i loguar në të). Një sesion fillon në momentin që përdoruesi hap për herë të parë një

prej faqeve të portalit dhe përfundon në momentin që ai largohet (mbyll të gjitha faqet e portalit) duke përfunduar shkëmbimin e të dhënave me të.

Gjatë një sesioni, përdoruesi mund të klikojë një ose më shumë faqe të portalit (si për shembull faqja kryesore, hapësira ime, institucionet, kontakt etj.) apo faqeve të shërbimeve të tij. Pavarësisht se sa faqe të ndryshme klikon përdoruesi nga momenti që ka hapur për herë të parë portalin e derisa e mbyll atë, numri i sesioneve mbetet një. Nëse përdoruesi mbyll të gjitha faqet e portalit dhe hap nga e para portalin, kemi fillimin e një sesioni të ri.

Nga 896,353 sesione në total:

- Sesione nga vizitorë që rikthehen në portal: 588,554 sesione ose 65.7% e totalit të sesione
- Sesione nga vizitorë të rinj: 307,799 sesione ose 34.3% e totalit të sesione

Grafik 3 *Sjellja e vizitorëve*

Grafiku i mëposhtëm (**Grafik 4**) tregon numrin total të sesioneve gjatë vitit 2016, sipas shteteve.

Shteti	Sesione 896,353 % of Total: 100.00% (896,353)	% e sesioneve të reja 34.34% Avg for View: 34.31% (0.09%)
1. Shqipëri	**837,839** (93.47%)	32.28%
2. Itali	**9,943** (1.11%)	62.22%
3. Greqi	**5,539** (0.62%)	56.13%
4. Kosovë	**6,004** (0.67%)	76.93%

5.	Mbretëri e Bashkuar	**4,066** (0.45%)	57.67%
6.	SHBA	**4,486** (0.50%)	70.20%
7.	Sudan	**2,188** (0.24%)	39.21%
8.	Gjermani	**3,061** (0.34%)	71.09%
9.	Rusi	**4,829** (0.54%)	80.95%
10.	E papërcaktuar	**1,775** (0.20%)	41.46%

Grafik 4 *Numri total i sesioneve gjatë vitit 2016, sipas shteteve*.

Grafikët për shërbimet elektronike më të përdorura

Më poshtë paraqitet nëpërmjet grafikëve (5 dhe 6) përdorimi i shërbimeve elektronike niveli 3 dhe 4 (sipas UNPAN2014) më të përdorura në portalin unik qeveritar e-Albania.al nga bizneset dhe qytetarët:

Shërbimet elektronike niveli 3 dhe 4 më të përdorura nga ***bizneset***:



Grafik 5 *Shërbimet elektronike niveli 3 dhe 4 më të përdorura bizneset*

Shërbimet elektronike niveli 3 dhe 4 më të përdorura nga ***qytetarët***:



Grafik 6 *Shërbimet elektronike niveli 3 dhe 4 më të përdorura nga qytetarët*

Portali unik qeveritar e-Albania lidhet me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit (Government Gateway), në të cilën janë lidhur 37 institucione, të cilat shkëmbejnë të dhëna në kohë reale dhe brenda vitit 2016, ky numër është rritur në 42. Më poshtë paraqitet grafiku i ecurisë së transaksioneve të kryera në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit për periudhat: 2013-2014-2015-2016.

Në **Grafikun 7** vërehet qartë rritje e numrit të transaksioneve të kryera në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit gjatë vitit 2016, periudhë gjatë së cilës janë kryer rreth 25.57 milionë transaksione, shifër e cila është 37,43 herë më e lartë se numri i transaksioneve të kryera gjatë gjithë vitit 2013 (683 207 transaksione gjatë këtij viti); 8,86 herë më i lartë se numri i transaksioneve të kryera gjatë gjithë vitit 2014 (i cili është rreth 2.88 milionë) dhe 2,24 herë më i lartë se numri i transaksioneve të kryera gjatë gjithë vitit 2015 (i cili është rreth 11.42 milionë). Mesatarja mujore e transaksioneve të kryera gjatë vitit 2016 është 2.13 milionë.



Grafik 7 *Numri i transaksioneve të kryera në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit gjatë vitit 2013, 2014, 2015, 2016.*

Grafiku i mëposhtëm (**Grafik 8**) tregon numrin e shërbimeve të reja elektronike në vitin 2013, 2014, 2015 dhe 2016, ku shihet qartë se gjatë vitit 2014 kemi një rritje me 105 shërbime të reja elektronike ose 8,5 herë krahasuar me vitin 2013, në vitin 2015 kemi 129 shërbime elektronike të shtuara ose një rritje prej 17,7-fish të numrit të shërbimeve elektronike krahasuar me vitin 2013 dhe në vitin 2016 janë shtuar 217 shërbime të reja duke e rritur totalin e tyre me 33 herë krahasuar me vitin 2013 (***Aneks 1.2*** mbi listën e plotë të shërbimeve në portalin unik qeveritar e-Albania)

Në portalin qeveritar e-Albania, në fund të vitit 2016, numri i shërbimeve elektronike niveli 1-2 (sipas UNPAN 2014) ishte 583



Grafik 8 *Numri i shërbimeve elektronike niveli 3-4 (sipas UNPAN 2014) në vitin 2013, 2014, 2015 dhe 2016*

Në vijim, ecuria e lidhjes së institucioneve në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit.

Nga grafiku 9 shihet qartë që në vitin 2013 kanë qenë të lidhura vetëm 6 institucione në ESB, ndërsa në vitin 2015 ky numër është 6,2-fishuar dhe në fund të 2016-s ishte 7 herë më i madh se ai në vitin 2013, duke numëruar në total 42 institucione të lidhura (***Aneks 1.4***). Kjo lidhje bën të mundur komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave midis institucioneve të ndryshme duke krijuar mundësinë e ofrimit të më shumë shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe vet qeverinë.



Grafik 9 *Ecuria e lidhjes së institucioneve në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit*

Me poshtë paraqiten të dhënat mbi regjistrimet e kryera përgjatë vitit 2016 të kategorizuara në qytetarë dhe biznese.



Grafik 10 *Regjistrimet e kryera gjatë vitit 2016, sipas profilit të përdoruesve*

Në grafikun e mësipërm **(grafik 10),** shihet përqindja e regjistrimeve të kryera në portalin qeveritar e-Albania për vitin 2016: 4% e përdoruesve i përkasin profilit biznes dhe 96% e të regjistruarve i përkasin profilit qytetar. Në total gjatë vitit 2016 janë regjistruar 71 703 përdorues.

Nëpërmjet **grafikut 11** paraqitet ecuria e regjistrimeve të kryera në portalin qeveritar e-Albania për vitet 2013 – 2014 – 2015 – 2016.



Grafik 11 *Numri i përdoruesve të rinj, 2013, 2014, 2015, 2016*

Gjatë vitit 2016 janë regjistruar 71703 përdorues të rinj. **Në total, janë 241 621 të regjistruar deri në 31.12.2016.**

Faqet e portalit janë klikuar 5,300,922 herë (dt. 01.01.2016 – 31.12.2016) dhe një përdorues ka shpenzuar mesatarisht 0:6:26 minuta duke shfletuar portalin. 65,7% janë përdoruesit që rikthehen në portal. Gjatë vitit 2016 janë kryer 265 pagesa elektronike. Janë kryer 336 aplikime për regjistrime fillestare të biznesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB); janë kërkuar 14,189 herë të dhëna për notat e provimeve të maturës; janë konsultuar 12,672 të dhënat familjare dhe të dhënat personale, janë depozituar 16,149 bilance vjetore në QKB, janë kërkuar 3,763 ekstrakte të nënshkruara elektronikisht nga QKB-ja; janë dorëzuar 182 aplikime për regjistrime të tjera të biznesit (ndryshime në të dhënat e regjistruara) në QKB, janë konsultuar 4276 herë pikët e drejtuesit të mjetit.

Në **grafikun 12** vërejmë se gjatë vitit 2016, numri më i lartë i përdoruesve që kanë marrë asistencë ka qenë muaji korrik dhe ai me numrin me të ulët të përdoruesve që kanë marrë asistencë ka qenë muaji janar.



Grafik 12 *Numri i përdoruesve që kanë marrë asistencë për vitin 2016*



Grafik 13 *Numri i përdoruesve që kanë marrë asistencë për 9 problematikat kryesore të hasura për vitin 2016*

Vërejmë se gjatë vitit 2016, numri më i lartë i përdoruesve që kanë marrë asistencë ka qenë për zhbllokim llogarie/reset fjalëkalimi.

Pika "Informacione dhe problematika të tjera" përfshin problematikat e mëposhtme:

- Informacion për shërbimin "Deklarimi i të ardhurave personale"
- Kërkesë për konfirmimin e pagesës së gjobës së automjetit
- Asistencë për shërbimin "Faturat e energjisë elektrike"
- Informacion për shërbimin "Deklarimi dhe pagesa e kontributeve nga punëdhënësit"
- Asistencë për aplikimin për licencë në QKL
- Asistencë për pikët e drejtuesit të mjetit

Totali i përdoruesve që kanë marrë asistencë për vitin 2016 është 5466 përdorues.

2. DREJTORIA E BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE

Drejtoria e Bazave të të Dhënave Shtetërore e ushtron funksionit e tij bazuar në Ligjin Nr. 10 325, datë 23.09.2010 "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 945, datë 02.11.2012 "Për miratimin e rregullores "Administrimi i Sistemit të Bazave të të dhënave Shtetërore". AKSHI, në bazë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 961, datë 24.11.2010 "Për përcaktimin e

Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore" ushtron kompetencën e tij në institucionet publike që krijojnë dhe administrojnë një ose më shumë baza të dhënash shtetërore, si dhe çdo person juridik privat në kuadër të bazave të të dhënave shtetërore, që ushtron funksion publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Dokumentacioni i bazës ligjore në formë elektronike mund ta gjeni në "link" si më poshtë:

- Ligj Nr. 10325 dt. 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore"
  http://akshi.gov.al/Legjislacioni/ligji_10325_per_databazat.pdf

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 945 dt. 02.11.2012 Për miratimin e Rregullores "Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore"
  http://akshi.gov.al/Legjislacioni/vkm_945_02_11_2012.pdf

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 961 dt. 24.11.2012 Për "Përcaktimin e Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore"
  http://akshi.gov.al/Legjislacioni/vkm_961_per_percaktimin_e_autoritetit_rregullator_koordinues_te_bazave_te_te_dhenave_shteteror.pdf

- Korniza Kombëtare e Ndërveprimit.
  http://akshi.gov.al/images/Korniza_kombëtare_e_ndërveprimit.pdf

Drejtoria e përbëhet nga dy sektorë.

2.1. *Sektori i i Regjistrimit dhe Standardeve të Databazave Shtetërore*

Detyra kryesore e këtij sektori është regjistrimi i bazave të të dhënave shtetërore dhe zbatimi i rregullave bazë për krijimin dhe administrimin e bazave të të dhënave shtetërore, si dhe ndërveprimin ndërmjet tyre, për të siguruar përdorimin me efektivitet nga çdo subjekt i interesuar.

Gjatë vitit 2016 ka vazhduar puna për identifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin të bazave të të dhënave shtetërore. Korrespondenca ka vazhduar me ato institucione të cilat kanë deklaruar se kanë në administrim baza të të dhënave shtetërore. Gjithashtu, me institucione të cilët po ndërtojnë një bazë të dhënë të re, janë organizuar takime bashkëpunimi me qëllim përcaktimin e arkitekturës së bazës së të dhënave në përputhje me kuadrin ligjor.

Gjatë vitit 2016 deri tani i është kthyer përgjigje **84** shkresave për përditësim dhe regjistrim të dokumentacionit të bazave të të dhënave shtetërore. Janë në shqyrtim dhe **6** shkresa të tjera.

Gjatë vitit viti 2016 është bërë regjistrimi i bazave të të dhënave shtetërore dhe koordinimi i tyre në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr.10325 datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" dhe aktet nënligjore në fuqi si dhe vlerësimi i dokumentacionin teknik dhe ligjor të bazës së të dhënave, të institucionit, i cili kërkon të regjistrojë një bazë të dhënash shtetërore dhe/ose për të ndryshuar përbërjen e të dhënave të mbledhura.

Janë regjistruar gjithsej **36** Baza të Dhënash Shtetërore nga **26** të tilla në vitin 2015.

Institucioni	Nr.	Kodi	Baza e të dhënave shtetërore
Ministria e Financave	1	**05-00-01**	Programi i Buxhetit Afatmesëm (PBA)
	2	**05-00-02**	Sistemi i Menaxhimit të Borxhit dhe Analizës Finanaciare (DMFAS)
	3	**05-00-03**	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ)
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	4	**05-02-01**	Sistemi i automatizuar për të dhënave doganore (ASYCUDA)
Qendra Kombëtare e Regjistrimit	5	**08-01-01**	Regjistri Tregtar (eRegister)
Qendra Kombëtare e Licencimit	6	**08-02-01**	Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve
Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	7	**08-03-01**	Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale (SAPI)
Drejtoria e Përgjthshme Standardizimit	8	**08-04-01**	Sistemi i Manaxhimit të Standardeve
Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	9	**10-03-01**	Regjistri Elektronik i Pasurive te Paluajtshme (ALBSREP)
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	10	**10-04-01**	Programi i Dëshmisë së Penalitetit
Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	11	**12-00-01**	Ndihma Ekonomike (NE)
Instituti i Sigurimeve Shoqërore	12	**12-01-01**	Sistemi arkivimit dhe menaxhimit te dokumenteve (vjetërsia në punë) DMAIS
	13	**12-02-02**	Sistemi elektronik për menaxhimin e kontributeve (CMIS)
	14	**12-02-03**	Sistemi i Kalkulimit dhe Pagesës së Përfitimeve (PCAMS)
Agjencia e Prokurimit Publik	15	**KM-01-01**	Sistemi elektronik i prokurimit(SPE)

Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë	16	**PJP - 06**	Sistemi i integruar i Administrimit të Informacionit të Përmbaruesit (SIAIP)
Agjencia Kombëtare e Provimeve	17	**09-01-01**	Sistemi Elektronik i Vlerësimit të Maturës Shtetërore
	18	**09-01-02**	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në IAL
	19	**09-01-03**	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
	20	**09-01-04**	Sistemi i Provimeve të Shtetit
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	21	**07-03-01**	Regjistri i Integruar i Territorit (RIT)
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	22	**06-02-01**	Regjistri Kombëtar i Mjeteve (eDPSHTRR)
	23	**06-02-02**	Regjistri Kombëtar i Personave të Aftësuar për Drejtimin e Mjeteve
Shërbimi Kombëtar i Punësimit	24	**12-02-01**	Sistemi i Shërbimeve të Punësimit
Drejtoria e Administratës Publike	25	**13-01-01**	Regjitri Qendror i Personelit (RQP)
Ministria e Zhvillimit Urban	26	**13-01-01**	Harta dixhitale e venddepozitimeve të mbetjeve urbane
Ministria e Drejtësisë	27	**10-00-02**	Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)
Drejtoria e Policisë Shtetit DPSH	28	**02-01-01**	Raportimi Online i Krimit Kompjuterik (ROKK)
	29	**02-01-02**	Sistemi i menaxhimit elektronik të gjobave (EGJOBA)
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile DPGJC	30	**02-02 -01**	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC)
Ministri për Çështjet Vendore MCV	31	**19-00 -01**	Sistemi Elektronik për Regjistrimin dhe Gjurmimin e të Dhënave mbi Rastet e Korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuara (ACT Albania)

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë BKSH	32	**11-01 -01**	Sistemi i integruar bibliotekar dataBKSH / dataNLA
Agjencia e Shërbimit Arkeologjik ASHA	33	**11-02-01**	DB gjeografike për regjistrimin në terren të ASHA
Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri"ë IMK	34	**11-03-01**	Databazë e Monumenteve të Kulturës të Shqipërisë
Ministria e Shëndetësisë MSH	35	**14-00-01**	Regjistri Elektronik Shëndetësor Kombëtar
Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ASIG	36	**13-04-01**	Gjeoportali Kombëtar

Përmendim faktin se në proces regjistrimi janë rreth **33** baza të dhënash në proces regjistrimi të cilët janë duke plotësuar/përditësuar dokumentacionin tekniko-ligjor.

Me qëllim përshpejtimin e procesit të regjistrimit të bazave të të dhënave shtetërore dhe për të arritur një komunikim sa më të mirë me institucionet të cilat administrojnë baza të dhënash shtetërore, janë organizuar takime në nivel ekspertësh në ambientet e AKSHI-t. Takimet janë mbajtur jo vetëm për Bazat e të Dhënave Shtetërore por edhe lidhur me projektet të cilët kanë qëllim ndërtimin e bazave të të Dhënave.



Gjithashtu gjatë vitit 2016 është rishikuar dhe nxjerrë v.2 i *"Aneksi template i dokumentacionit teknik për regjistrim të bazave të të dhënave*" në përmbajtje të pikave të cituara në nenet 11, 12 dhe 13 të VKM-së Nr. 945, datë 2.11.2012 për miratimin e rregullores "Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore".

2.2. *Sektori i Auditimit të Databazave Shtetërore*

Ky sektor përgjigjet për realizimin e auditimeve dhe respektimin e kërkesave ligjore për bazat e të dhënave shtetërore.

Procesi i auditimit të bazave të të dhënave shtetërore

Përgjegjës për autorizimin nëpërmjet një ekspertize të kualifikuar e të pavarur për auditimin e Bazave të të Dhënave Shtetërore është Autoriteti Rregullator Koordinues (ARK) rol të cilin e luan Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) bazuar në VKM nr. 961 dt. 24.11.2010 "Për përcaktimin e Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore".

Ky sektor përgjigjet për realizimin e auditimeve dhe respektimin e kërkesave ligjore për bazat e të dhënave shtetërore.

Për vitin 2016 janë kryer auditimet sipas kërkesave të nenit 24 pika 3 të Vendimi të Këshillit të Ministrave Nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore" , procesi i auditimit të bazave të të dhënave shtetërore përfshin si më poshtë:

a) verifikim e përputhshmërisë me inventarin e aseteve të sistemit;
b) kontrollin nëse baza e të dhënave ka klasën dhe nivelin e sigurimit të përshtatshëm;
c) kontrollin nëse masat e sigurisë janë përzgjedhur dhe zbatohen në pajtueshmëri me kuadrin ligjor në fuqi;
d) shqyrtimin e dokumentacionit teknik të bazës së të dhënave;

Grupet e Auditimit të ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për bazat të të dhënave shtetërore në institucionet "Instituti i Sigurimeve Shoqerore", "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave" , "Agjencia e Prokurimit Publik" dhe "Ministria e Financave". Për sa më sipër janë hartuar raportet përfundimtare për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Ndërsa në Agjencinë e Prokurimit Publik procesi i auditimit është pezulluar, kjo për shkakun e një kërkese nga ana e tyre që auditimi të kryhet pasi të përfundojë projekti "Riinxhinierim dhe shtim funksionalitetesh/shërbimesh në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re", pasi sistemi SPE në administrimin e Agjencise së Prokurimit Publik ndodhet në proces upgrade në të gjithë infrastrukturën e tij, si pasojë e këtij projekti, do të ketë ndryshime në arkitekturë dhe pajisje. Kërkesa është marrë në konsideratë në mënyrë që auditimi të jetë sa më efektiv dhe pa cënuar sigurine e sitemit SPE.

Procesi i auditimit në Ministrinë e Financave për bazat e të dhënave shtetërore në administrimin të Ministrisë së Financave :

1. Programi i Buxhetit Afatmesëm (PBA);
2. Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ);
3. Sistemi i Menaxhimit të Borxhit dhe Analiza Ekonomike (DMFAS);

ndodhet në statusin e përditësimit te informacionit. Kjo për shkakun se dy bazat e të dhënave , Sistemi I Menaxhimit të Borxhit dhe Analiza Ekonomike (DMFAS) dhe Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) kanë pësuar ndryshime nga infrastruktura ekszistuese dhe janë konstatuar mangësi në dokumentacionin teknik. Gjithashtu dhe Programi i Buxhetit Afatmesëm (PBA) ka mangësi në dokumentacionin teknik.

ARK, në zbatim të nenit 24 të VKM nr. 945 pika 4 ku cilësohet se, në qoftë se gjatë procesit të auditimit për herë të parë, konstatohen mangësi, atëherë auditimi i bazës së të dhënave shtetërore pezullohet, për t'i dhënë institucionit administrues mundësinë e eliminimit të mangësive të konstatuara. Në këtë rast, bazat e të dhënave shtetërore janë të detyruara të eliminojnë mangësitë e konstatuara. Procesi i auditimit për Ministrinë e Financave do të rifillojë më datë 20 Janar, 2017.

Problematikat gjatë procesit të auditimit të bazave të të dhënave shtetërore

Disa nga problematikat më kryesore të evidentuara në bazat e të dhënave shtetërore janë:

1. Në zbatim të Ligjit 10325/2010 "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore", si dhe Vendimit Nr. 945 datë 02.11.2012 "Për Miratimin e rregullores "Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore", Agjencia për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) ka miratuar një udhëzim "Për masat e sigurisë për bazat e të dhënave shtetërore"i publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 16 datë 25.04.2016. Ky udhëzim i është dërguar për njohje të gjitha institucioneve, të cilat administrojnë një bazë të dhënash shtetërore.
   Zbatimi rigoroz i udhëzimit të ALCIRT-it ka patur një ndikim të drejtpërdrejtë në procesin dhe punën e grupit të auditimit. Kjo për shkakun se parashikimi i masave të marra në lidhje me sigurinë, duke u bazuar në udhëzimin e nxjerrë nga ALCIRT, do të sjellë ndryshime dhe në dokumentacionet teknik, masat e sigurisë të institucioneve të dërguara pranë AKSHI-t. Kështu që institucioneve u është lënë një periudhe për njohjen e udhëzimin dhe ndryshimin e dokumentacioneve teknike të dorëzuara pranë AKSHI-t.

2. Grupet e auditimit, të ngritura me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, kanë vërejtur deri më tani në auditimet e zhvilluara:

   - Mungesë e përditësimit të dokumentacioni teknik të dorëzuar në ARK, në rastet kur bazat e të dhënave shtetërore kanë pësuar ndryshime (upgrade) në sistemet e tyre në një infrastrukturë të re apo në atë ekzistuese. Në 4 (katër) institucionet që kemi përmbushur në planin e punës të auditimit në vitin 2016 për bazat e të dhënave në administrim të tyre, këto ndryshime duhet të ishin depozituar pranë ARK/AKSHI, në bazë të nenit 6, të VKM 945, datë 02.11.2012.
   - Institucionet kanë dokumentacione jo në gjuhën shqipe.
   - Institucionet nuk kanë një rregullore të miratuar nga titullari i institucionit.
   - Kontrollet e Nivelit dhe Nënklasave të Sigurisë - verifikimin e nivelit të dorëzuar në dokumentacion gjatë regjistrimit të bazës së të dhënave me nivelin që formohet nga klasat

e sigurisë (disponueshmëri, integritet dhe konfidencialitet) nuk është ai i dokumentacionit që kanë dorëzuar. Gjithashtu nga institucioni nuk është dokumentuar analiza e sigurisë në varësi të së cilës përcaktohen nënklasat e sigurisë, të pavaruara nga njëra-tjetra, siç kërkohet në bazë të nenit 17, pika 1 të VKM-së 945, datë 02.11.2012.

2.3. *Procesi i ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore*

Ndërveprimi, në kontekstin e ofrimit të shërbimeve publike, është aftësia e organizatave të ndryshme për të bashkëvepruar në qëllime të përbashkëta, duke përfshirë ndarjen e informacionit dhe njohurive nëpërmjet proceseve të tyre të punës, të realizuara këto midis shkëmbimit të të dhënave ndërmjet sistemeve të tyre përkatëse TIK. Komunikimi në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit bëhet i mundur sipas nenit 9 pika 5 të VKM-së Nr.945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "Administrimi i Sistemit të Bazave të të dhënave Shtetërore". Duke ju referuar nenit 8 të Ligjit Nr. 10 325, datë 23.09.2010, "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore": *"...ndërveprimi ndërmjet bazave të të dhënave shtetërore bëhet vetëm me të dhënat parësore..."*. Ndërveprimi i bazave të të dhënave shtetërore realizohet nëpërmjet **Platformës Qeveritare të Ndërveprimit**, e cila është një platformë kyçe e realizimit të ndërveprimit të sistemeve të cdo institucioni publik ose referuar dhe nenit 2, pika 1b) i Ligjit Nr. 10 325, datë 23.09.2010, "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore": "...administratorët e bazave të të dhënave që krijohen ose administrohen nga cdo person juridik privat, që ushtron funksion publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi...".

Qëllimi i Ndërveprimit:

- ✓ Të nxisë dhe mbështesë shpërndarjen e shërbimeve publike duke nxitur ndërveprimin ndërmjet sektorëve;
- ✓ Të udhëzojë administratën publike, në mënyrë që të ofrojë shërbime publike për biznesin dhe qytetarët, në një platformë të orientuar nga qytetari dhe shërbimet;
- ✓ Ndërtimi i një platforme në të cilën të jenë të integruara të gjitha sistemet informatike që ofrojnë shërbime publike.

Në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit deri në fund të vitit 2016, **ndërveprojnë 42 institucione.**

- 12 institucione të ndërlidhura në 2014;
- 17 institucione të ndërlidhura në 2015;
- 13 institucione të ndërlidhura në 2016;

Duke u nisur nga sa më lart deri tani është punuar për koordinimin e hapave të punës për ndërveprim të bazave të të dhënave shtetërore që janë në zhvillim e sipër si edhe për ato baza të dhënash shtetërore të cilat do të ndërtohen në të ardhmen. Janë shqyrtuar të gjitha shkresat që kanë ardhur dhe janë kthyer përgjigje brenda afateve të parashikuar në ligj.



2.4. *Plani i Auditimit për vitin 2017*

Gjatë vitit 2017 sektori i auditimit ka përmbyllur gjithsej 3 auditime dhe plani i punës për auditim në terren, ky plan ndryshon në mënyrë periodike pasi në një moment të caktuar mund t'i jepet prioritet një baze të dhënash e cila mund të mos ishte parashikuar më parë. Ky plan pune do fillojë të zbatohet në fund të muajit shkurt të 2017, në këtë plan renditja e bazave të të dhënave që do të auditohen është vendosur sipas një rregulli që është menduar nga Drejtoria e Regjistrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore. Me prioritet të lartë per t'u audituar do të jenë bazat e të dhënave të cilat janë të regjistruar më herët dhe kanë nivel të lartë sigurie. Institucionet të cilat do të auditohen në vijimësi të vitit 2017 janë: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Drejtoria e Administratës Publike, Ministria e Drejtësisë, Qendra Kombëtare e Biznesit etj.

2.5. *Detyra të tjera*

Përveç detyrave kryesore me të cilat ka të bëjë drejtoria, bazuar në funksionalitete që rrjedhin nga kuadri ligjor, janë realizuar dhe detyra të tjera të ngarkuara janë:

- Dixhitalizimi në kuadër të Strategjive Axhendës Dixhitale 2015-2020 dhe Reformës PAR.
- Plani për dokumentet shoqëruese të shërbimeve dhe shkëmbimin e tyre elektronikisht.
- Shqyrtimi i projekteve që kanë lidhje me bazat e të dhënave
- Ndjekja e kontratave

2.5.1 Dixhitalizimi

Bazuar në strategjitë:

- *AXHENDA DIXHITALE E SHQIPËRISË 2015-2020 "*

- *STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2015 – 2020*

Ku vizioni është:

- Një shoqëri e bazuar në dije dhe informacion, nëpërmjet konsolidimit të infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike online dhe rritjes së transparencës së qeverisjes."
- Zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime më cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative…

AKSHI sipas objektivave:

DA Prioriteti strategjik 1:	Politika për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimi i shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset.
DA Prioriteti strategjik 2:	*Politika për zhvillimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët (shëndetësi, arsim, mjedis, bujqësi, turizëm, kulturë, energji, transport etj)*
PAR Objektivi 9:	Zhvillimi i një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e eficensës duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit

dhe së bashku me ISDA, ADISA, si dhe me institucionet ka ndërmarrë masat për përmbushjen e këtyre prioriteteve dhe objektivave, veçanërisht për objektivin Nr. 2 "Inovacioni kundër korrupsionit - Qendra me Një Ndalesë - Reforma e shërbimeve në Administratën Publike (dixhitalizimi)" nën Prioritetin Strategjik 1.

Në kuadër të kësaj reforme AKSHI ka qenë pjesë aktive në mbledhjet javore në Komitetin Drejtues të reformës si dhe në mbledhjet raportuese pranë ISDA.

2.5.2 Plani për dokumentet shoqëruese të shërbimeve dhe shkëmbimin e tyre elektronikisht

Ky dokument është pjesë dhe vjen në zbatim të detyrave që rrjedhin nga projektet e "Planit të veprimit të strategjisë Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020", për realizimin e të cilit janë përgjegjës institucionet qendrore dhe jo vetëm.
Në këtë kuptim ai paraqet angazhimin e AKSHI-të në përmbushjen e detyrimeve të veta në lidhje me afatet, por edhe për realizimet teknike të domosdoshme për finalizimin e punës.
"Plani për dokumentet shoqëruese të shërbimeve dhe shkëmbimin e tyre elektronikisht" konsiston në ndjekjen nga afër dhe realizimin e këtyre projekteve:

1. Shërbimet elektronike
2. Projekte për institucionet që kanë sisteme elektronike por nuk janë në platformën qeveritare të ndërveprimit (GG)
3. Projekte për institucionet që nuk kanë sisteme elektronike
4. Sistemi i qendërzuar i menaxhimit të dokumenteve me firmë dixhitale (për dokumentet që lëshohen nga institucionet që nuk kanë sisteme elektronike të implementuara dhe nuk janë të lidhura në GG)(ende nuk është konfirmuar buxheti i institucionit për vitin 2017).
5. Institucionet pilot që janë parashikuar të iniciojnë dhënien e dokumenteve në format elektronik(kostoja e pacaktuar).

Në total preken 434 shërbime.

Ecuria e projekteve

Nga të gjitha projektet, AKSHI është përgjegjësi kryesor, por jo i vetëm institucional për:

1. Shërbimet elektronike që ofrohen në portalin e-Albania për përdorimin nga nëpunësit civilë dhe vula elektronike

2. Shërbimet elektronike që do të implemetohen nga kontrata e 209 shërbimeve elektronike

për të cilat kontrata e zbatimit është në ndjekje.

Për të gjitha projektet e tjera përzgjegjësia e zbatimit është shumëpalëshe, mes AKSHI-t dhe institucioneve përfituese të shërbimeve të reja.

- Për shërbimin **"Të dhëna që do të ekspozohen në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit në vitin 2017"** (fond i parashikuar por buxhet ende i pakonfirmuar), është zhvilluar komunikimi shkresor për përshtatjen, kostimin e sistemeve dhe për kohën e nevojshme për implementimin e ndryshimeve në bazën e të dhënave të institucionit për të ekspozuar të dhëna në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit. Nga të gjitha komunikimet ka vetëm një përgjigje nga DPD që kërkon kohë për përcaktimin e kostove dhe kohës së implementimit (AKSHI ka kërkuar me një shkresë të dytë një afak konkret).

- Për **"Përshtatja e sistemeve ekzistuese për të pritur të dhëna nga platforma qeveritare e ndërveprimit në kohë reale"**(ende për t'u kostuar), kanë kthyer përgjigje MAS, DPSHTRR, të

cilat kanë kërkuar kohë për hartimin e projekteve dhe studimin e tregut për përcaktimin e kostos. (AKSHI ka kërkuar me një shkresë të dytë një afat konkret). Për institucionet e tjera(nëntë) AKSHI ka përsëritur komunikimin shkresor.

- Për projektin **"Sistemi i qendërzuar i menaxhimit të dokumenteve me firmë dixhitale (për dokumentet që lëshohen nga institucionet që nuk kanë sisteme elektronike të implementuara dhe nuk janë të lidhura në GG)"** (buxheti i institucionit për 2017-ën ende i pakonfirmuar) janë vënë në dijeni zyrtarisht, në mënyrë të përsëritur, 21 instiucione apo drejtori, si dhe të 61 bashkitë e vendit.

Për projektin "Institucionet pilot që janë parashikuar të iniciojnë dhënien e dokumenteve në format elektronik", parashikuar për deri në qershor të vitit 2017, nevojitet caktimi i fondit. Shtojmë se në kuadër të këtij projekti janë 9 shërbime të reja që prekin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2.5.3. Shqyrtimi i projekteve që kanë lidhje me bazat e të dhënave

Drejtoria e Bazave të të Dhënave, ka shqyrtuar dhe po shqyrton në vazhdim projekte të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin apo përmirësimin e bazave të të dhënave shtetërore.

Afërsisht janë shqyrtuar rreth **28** projekte të ardhura për miratim pranë AKSHI.

Gjatë vitit 2016 drejtoria është angazhuar gjithashtu në grupe të përbashkëta pune për ndërtimin sistemeve të reja si DPSHTRR, MD, ALUIZNI, DPGJC, MSH, MAS, MEI, QKB, etj.

2.5.4. Ndjekja e projekteve

Personeli i Drejtorisë së Bazave të të Dhënave, përveç detyrave të lartpërmendura, angazhohet dhe në ndjekjen e kontratave që institucioni po zbaton, grupe pune për hartimin e termave te referencës si dhe KVO por edhe projekte të tjera të klasifikuara.

Kontrata janë:

1. Mirëmbajtja e infrastruktures ODA X3-2 (Audit vault).
2. Mirëmbajtja e sistemeve Oracle Audit Vault (përfshirë dhe mirëmbajtjen 2 vjet).
3. Sistem mbrojtës të dhënash për databazën e sistemit të thesarit.
4. Shtimi i 209 shërbimeve të reja për 18 institucione.
5. Blerje software për përpunimin e të dhënave, Arkiva e dixhitalizuar dhe pajisje skanimi, server+pajisje depoz. të dhëna Arkiva Dixhitale.
6. Sistemi i menaxhimit të projekteve për aprovim.

Hartim terma reference:

1. Bileta për udhëtime jashtë shtetit.
2. Sistemi i menaxhimit të projekteve.
3. Krijim i Regjistrit të Koncensioneve dhe Partneritetit Publik Privat.

KVO:

1. Mirëmbajtja e Infrastrukturës së Celësit Publik.
2. Portali e-Albania.
3. Projektimi i Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës 'Business Continuity Center' për Sistemet Qeveritare.
4. Konfigurimi i pajisjeve për nënshkrimin elektronik në institucionet shtetërore në kuadër të projektit E- Leje.
5. Arkiva elektronike per sistemin e dokumentit elektronik per ministrite e linjes.
6. Blerje shërbim Interneti i përqëndruar 350 Mbit/s, brenda vitit 2016 - Linja nr. 2.
7. Blerje shërbim Interneti i përqëndruar 800 Mbit/s, brenda vitit 2016 - Linja nr. 3.
8. Bileta për udhëtime jashtë shtetit.
9. Upgrade i Sistemit të UPS të Datacenterit Qeveritar.

3. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 703 datë 29.10.2014 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit', si edhe Urdhrit Nr. 59 datë 23.04.2015 "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Drejtoria e Infrastruktures e-Gov përbëhet nga dy sektorë:

1. Sektori i Administrimit të Rrjetit Govnet
2. Sektori i Serverave dhe Infrastrukturës mbështetëse të sistemeve.

Drejtoria e Infrastrukturës menaxhon dhe mirëmban rrjetin fizik me fibër optike, pjesën akses dhe shpërndarje të tij, komunikimet e brendshme dhe ato të jashtme. Gjithashtu ajo është përgjegjëse për krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme rrjeti për të siguruar punën e shërbimeve në rrjetin e sistemeve e-Gov, për lidhjen e institucioneve të reja në këtë rrjet për marrjen e shërbimeve, menaxhimin e lidhjeve ekzistuese, si dhe ofrimin e shërbimit të furnizimit me internet për institucionet e administratës publike.

3.1. Sektori i Administrimit të Rrjetit Govnet

Optimizim të sistemeve të monitorimit për pajisjet e rrjetit me qëllim kryesor rritjen e performancës së këtyre sistemeve, azhornim i pajisjeve nën monitorim dhe krijmi/mbledhja e informacioneve apo raporteve për një tast të caktuar në një kohë sa më të shpejtë.

1. ***Optimizimi i sistemit të monitorimit të trafikut dhe rrjetit - Cacti*** – Eshtë azhornuar sistemi me të gjitha pajisjet e reja të rrjetit për infastrukturat e mëposhtme:
   a) Core(Data Center)
   b) Rrjeti i Distribucionit dhe Aksesit
   c) DIS servers
   d) PKI Site
   e) e-Albania, Production dhe TEST

Janë azhornuar skemat e rrjetit për të gjitha këto infrastruktura për të monitoruar kalimin (flow) e trafikut të këtyre rrjeteve, për qëllim të analizës së trafikut, matje të performancës së rrjetit, etj. Gjithashtu për të gjitha Firewall-et e implementuara (Fortinet, Checkpoint, ASA) në infrastrukturën e rrjetit, është bërë i mundur kalimi i log-eve në Splunk në mënyrë që cdo veprim dhe ndryshim të jetë lehtësisht i gjurmueshëm në rast problematikash. Log-et e konfiguruara në Splunk për sisteme kritike si Checkpoint apo disa prej firewall-eve Fortinet, dërgohen edhe automatikisht tek netadmin@akshi.gov.al, i cili monitorohet nga sektori.



Figura 1. *Paraqitje nga Sistemi i Monitorimit Cacti, skemat kryesore të monitorimit*

Skemat në figurën mësipër janë azhornuar me ndryshimet përkatëse të bëra gjatë vitit 2016.

2. ***Sistem i identifikimit të shërbimeve - Observer -*** Sistem me qëllim kryesor identifikimin e shpejtë të funksionit të portave të rrjetit (porta ku lidhen institucionet e ndryshme, kapaciteti internet i përcaktuar, shërbimet që marrin, etj. Porta ku lidhen Upstream Provider, Servera, DIS-et, sisteme të hostuara, user-a etj), monitorimi i trafikut. Ky sistem gjatë vitit 2016 është azhornuar dhe optimizuar në mënyrë që të shërbejë sa më mirë për të identifikuar problematika të ndryshme.



Figura 2. *Paraqitje e profilit të portave*

Funksioni tjeter i rëndësishëm është instalimi i skripteve të cilat bëjnë back-up ditore të automatizuara për gjithë pajisjet Cisco të rrjetit, Firewall-et ASA, Firewall-et Fortinet. Gjatë 2016, sistemi është populluar me skripte të reja në shërbim të back-up-eve. Gjithashtu skriptet ekzistuese janë optimizuar për të ruajtur sa më mirë konfigurimet e paisjeve të ndryshme të rrjetit.

```
[root@observer home]# ll -a
total 140776
drwxr-xr-x.   8 root root      4096 Sep 23 17:17 .
dr-xr-xr-x.  25 root root      4096 Nov 24 04:00 ..
drwxr-xr-x    2 root root      4096 Sep 21 17:16 ASABACKUP
-rwxr-xr-x    1 root root      1248 Jul  1 17:02 asa-backup.pl
-rwxr-xr-x    1 root root      9273 Jul  8 21:41 check_fortigate_vpn.pl
-rwxr-xr-x    1 root root      1167 Jul  1 12:39 cisco-backup.pl
drwxrwxrwx  153 root root      4096 Nov 24 04:00 FORTIBACKUP
-rwxr-xr-x    1 root root      1151 Jun 29 10:00 fortibackup.pl
-rwxr-xr-x    1 root root      1048 Sep 23 16:55 fortibackuptest.pl
-rw-r--r--    1 root root     15912 Oct  3  2008 IOSmap.tcl
drwx------.   2 root root     16384 Mar 13  2014 lost+found
drwxrwxrwx  274 root root     12288 Nov 24 01:17 NETBACKUP
drwxr-xr-x    2 root root      4096 Oct  6 16:40 NETOS
-rw-r--r--    1 root root 143996420 Jul  2 14:53 observium.sql
-rw-r--r--    1 root root       389 Sep 22 14:49 q
-rw-r--r--    1 root root     42121 Sep 15  2008 services.list
drwxrwxrwx    2 root root     12288 Nov 24 01:17 tftpd
```

Figura 3. *Folderat dhe scriptet e back up-it*

3. **Sistem i Inventarit - DCIM** - Sistem për inventarizim të automatizuar të të gjithë aseteve të Data Center-it ku përfshin pajisje rrjeti, sisteme etj. Nxjerrja e raporteve të kapaciteteve Data Center.



Figura 4. *Paraqitje e panelit kryesor të AKSHI-DCIM, hapësirat e zëna, energjia e shpenzuar, etj.*

Gjatë vitit 2016 pranë AKSHI kanë ardhur kërkesa të shumta të kolokimeve fizike, si edhe janë implementuar disa projekte të institucionit tonë. Paisjet hardware të vendosura në DataCenter-in Qeveritar janë pasqyruar në këtë sistem dhe azhornohen rregullisht pas cdo ndryshimi.



Figura 5. *Paraqitje e hapësirave të zëna në një rack, network-room.*

4. **Cisco LMS, Cisco Prime** – Upgrade i këtyre sistemeve në versionet më të fundit të sistemeve operative. Azhornimi i listës së pajisjeve të cilat janë nën monitorim. Konfigurim i pajisjeve të rrjetit për dërgimin e logs tek këto sisteme.

5. **Optimizime në rrjet** – Qëllimi kryesor rritja e performancës së rrjetit për të ofruar shërbime cilësore:
   - Optimizim i rrjetit MPLS, ndryshimet përkatëse në të gjitha paisjet e rrjetit (Router dhe switch) të shpërndara në institucione
   - Shtim i konfigurimeve në Routerin për agregimin e trafikut të DIS serverave të instaluar në Data Center.
   - Update IOS dhe firmware për gjithë pajisjet e rrjetit Cisco dhe Fortinet.
   - Update i firmware-t për Firewall-et Checkpoint dhe optimizimi i sesioneve të tyre për mbrojtjen nga sulmet Ddos.
   - Update i firmware për Access Points per rrjetin WiFi.
   - Optimizim i prefix-list-ave për të kontrolluar routimet OSPF midis core-routerave dhe fireëall-eve të shërbimeve për të shmangur routing-loops.
   - Përmirësim i rrjetit akses për Public Cloud, rritja e redundances.

6. **Implementim i Projekteve** - Qëllimi kryesor është integrimi i sistemeve të reja të administratës dhe të vetë AKSHI në rrjetin GovNet:
   - Integrimi në rrjetin GovNet i Arkives Elektronike
   - Integrimi në rrjet i infrastrukturës së re të APP
   - Ofrim i infrastrukturës së rrjetit për institucionet të cilat serverat DIS i hostojnë në DataCenter-in Qeveritar. Suport në lidhje me komunikimet midis shërbimeve të ndryshme në kuadër të shtimit të shërbimeve në portalin qeveritar e-albania
   - Integrimi në rrjetin Govnet i Platformës Heterogjene për sistemet e institucioneve publike

7. **Lidhje të reja të institucioneve në Govnet**

Gjatë vitit 2016 është bërë e mundur lidhja me fibër optike e 5 institucioneve të reja. Gjithashtu është bërë trasferimi i lidhjeve për rreth 4 institucione për shkak të ndryshimit të vendndodhjes. Eshtë ofruar shërbim akses i sigurt në internet dhe shërbime e-Gov për të gjithë këto institucione.



Grafiku 1 *Paraqitje grafike e lidhjeve në Govnet*

3.2. Sektori i Serverave dhe Infrastrukturës Mbështetëse të Sistemeve

1. **Upgrade i firmware të BIOS dhe drivers per "Private Cloud" dhe "Public Cloud"**
   Eshtë bërë upgrade i firmware dhe drivers për të gjitha nyjet e "Private Cloud" dhe "Public Cloud" ne funksion te rritjes se performances.

2. **Optimizim në Private Cloud**
   Eshtë kryer gjithashtu upgrade i "Private Cloud" me dy nyje te tjera duke arritur nje total prej 12 nyjesh, me qëllim rritjen e pe rformancës së cloud-it.

Name	Host Status	Role
pvt-cl01-srv1.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srv2.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srv3.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srv4.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srv5.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srv6.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srv7.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srv8.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srv9.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srva.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srvb.gov.local	OK	Host
pvt-cl01-srvc.gov.local	OK	Host

3. **Implementim i Platformes Heterogjene** – (DSIK)

4. **Implementim i Arkives Elektronike** – (DSIK)

5. **Hostim fizik/vendndodhje e përbashkët (co-location) në Data Center Qeveritar**

AKSHI, me anë të Data Center Qeveritar, të ndërtuar në ambientet e tij, ofron hapësire fizike - Rack, hapësire "U" në Rack për shërbimet e institucioneve qeveritare. Nëpërmjet Data Center sigurohen kushtet më optimale të energjisë, ftohjes, konektivitetit dhe sigurisë për këto pajisje. Data Center Qeveritar është i pari këtij lloji në Republikën e Shqipërisë dhe është ideuar të ofrojë ambient vendosjeje 100 % të sigurt nga ana fizike dhe logjike për shërbimin që ai ofron.

Gjatë vitit 2016 është ofruar ky shërbim per 11 institucione të tjera duke e çuar numrin total në 43. Janë kryer konfigurimet në rrjet për lidhjen e platformave të hostuara, integrimin në Govnet dhe publikimin e tyre sipas kërkesave specifike.



***2** Paraqitje grafike e sistemeve të hostuara fizikisht në Data Center*

6. **Shërbim hostimi për portale ëeb dhe për sisteme informacioni të administratës publike**

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ofron shërbimin e hostimit të portaleve zyrtare si dhe të sistemeve të informacionit të administratës publike në "Private Cloud", të ndërtuar nga AKSHI, në shërbim të institucioneve të qeverisë shqiptare.Gjatë vitit 2016 është bërë e mundur shtimi i 67 faqeve web dhe portale.



Grafiku 3 *Paraqitje grafike e web-faqeve/portaleve të hostuara në Cloud-in e AKSHI-t*

7. Shërbim DNS Publik dhe Privat

AKSHI, nëpërmjet zgjerimit të rrjetit Govnet, i cili është një rrjet privat qeveritar në Fiber Obtike (FO) dhe nëpërmjet infrastrukturës CORE NETWORK dhe DISTRIBUTION NETWORK, e ndërtuar nga pajisje të një teknologjie të fundit dhe me një siguri të avancuar, ka arritur të jetë prezent në pjesën më të madhe të institucioneve qeveritare duke shpërndarë internet dhe shërbime të tjera të përqendruara. Një nga këto shërbime është edhe DNS privat dhe publik që ofron Agjencia për institucionet qeveritare. DNS publik shërben për të lidhur informacionin që përmban zona e domain me IP publike të përcaktuara. DNS private shërben për të lidhur informacionin që përmban zona e domain me IP private, të cilat janë të arritshme për institucionet e lidhura në Govnet.

Ky shërbim është ofruar për 49 insitucione gjatë 2016 duke e çuar numrin total në 303 zona. Gjithashtu janë optimizuar me tej parametra specifike për të gjithë zonat e konfiguruara në DNS për të rritur performancën e këtij sistemi.



Grafiku 4 *Paraqitje grafike e numrit të zonave në DNS-të publike*

4. DREJTORIA E SISTEMEVE e-GOV

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 703 datë 29.10.2014 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit', si edhe Urdhrit Nr. 59 datë 23.04.2015 "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Drejtoria e Sistemeve e-Gov pësoi një ndryshim në përbërje dhe në detyrat funksionale të saj. Ajo përbëhet nga 2 sektorë:

1. Sektori i Menaxhimit të Sistemeve
2. Sektori i Programimit dhe Zhvillimit

Drejtoria e Sistemeve e-Gov menaxhon dhe mirëmban Sistemet Elektronike qeveritare që zotëron Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në shërbim të vetë Agjencisë ose më gjerë, të qeverisë dhe institucioneve qeveritare, sikurse përcaktohet në VKM të krijimit të Agjencisë. Ajo punon ngushtë me Drejtoritë e tjera për ofrimin e shërbimeve të përqendruara qeveritare. Po ashtu zhvillon sisteme informatike në funksion të nevojave të Agjencisë, Kryeministrisë ose institucioneve qeveritare.

4.1. Sektori i Menaxhimit të Sistemeve

Gjatë vitit 2016, sektori i Menaxhimit të Sistemeve ka realizuar ofrimin e shërbimeve dhe mbajtjen e sistemeve online 24/7 ndodhur gjithmonë nën presionin e kërkesave në rritje dhe gjithashtu të ndryshimeve në stafin e saj.

AKSHI ka një infrastrukturë të ngritur si Data Center që shërben për dhënien e një sërë shërbimesh të rëndësishme për institucionet publike. Shërbimet e ofruara përfshijnë:

- Posta elektronike qeveritare (Gov mail);
- Autentifikim dhe identifikim të sigurt (Active Directory);
- Licencim qendror i sistemeve operative kliente të Microsoft;
- Menaxhim qendror i mbrojtjes antivirus;
- Komunikim tekst i menjëhershëm, video dhe zanor;
- Instalim automatik dhe qendror të aplikimeve;
- Update të sistemeve klient dhe server;
- Shërbimi i personalizuar OneDrive;

Realizimet e listuara më poshtë kanë tregues në rritje të performancës.

4.1.1 Active Directory

AKSHI ofron mundësinë për realizimin e menaxhimit dhe administrimit qendror të PC-ve dhe përdoruesve. Si sistem bazë përdoret Microsoft Active Directory, i cili menaxhon autorizimin, autentikimin dhe identifikimin e përdoruesve. Sistemi bazë ku është ngritur Active Directory është bere upgrade ne Windows Server 2012 R2.

Topologjia e rrjetit të Active Directory përbëhet nga (4) katër Domain Controller në Site Qendror dhe (8) tete RODC – Read Only DC, kjo për arsye sigurie, të shpërndara nëpër site për të ofruar shërbime të domain.

AKSHI mirëmban të gjithë infrastrukturën e sistemit të Active Directory jo vetëm në Data Center por edhe në site-t e institucioneve, së bashku me rolet e ngritura mbi të: DNS dhe File Server në disa site.

Roli i DHCP eshte implementuar ne Datacenter e AKSHI, si një sherbim i qendërzuar dhe me disponueshmëri të lartë dhe aktualisht janë dy servera DHCP, të cilët lëshojnë IP për të gjithë kompjuterat e Ministrive dhe Institucioneve.



Grafiku 1 *Numri i përdoruesve në Active Directory*

Numri i Institucioneve me akses në DC per menaxhim Active Directory Users and Computers – 35.
Numri total i perdoruesve në AD është aktualisht 18333.
Vërehet se numri i përdoruesve prej vitit 2015 në vitin 2016 ka pësuar rritje me 1,11 herë.

4.1.2. Shërbimi i ofrimit të postës elektronike zyrtare për administratën publike

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) nëpërmjet infrastrukturës së saj për shërbimet e përqendruara ofron shërbimin e postës elektronike sipas standardeve në formatin "emer.mbiemer@institucioni.gov.al" për institucionet publike në nivel qendror dhe disa institucione të pavarura. Ky shërbim ofrohet në një cilësi të lartë, duke përfshirë sigurinë ndaj spam, malware, virus etj, si dhe duke garantuar një shërbim 24 orë në ditë për 365 ditë të vitit. Shërbimi gjithashtu përfshin edhe suportin teknik (helpdesk) ndaj institucioneve përfituese.

Gjatë vitit 2016 ky shërbim është ofruar për rreth **2407** përdorues te rinj, duke arritur në një total prej 15835 mailbox-esh. Më poshtë grafiku i ecurisë në vite.



Institucione që marrin shërbimin e postës elektronike: 150

Prej vitit 2015 në vitin 2016 vërehet rritje në numrin e përdoruesve me **2407 –** Rritje me **15%**

4.1.3. Komunikim tekst i menjëhershëm, video, zanor, chat, konferencë dhe web konferencë

Ky shërbim bën të mundur komunikimin video, zanor si edhe nëpërmjet mesazheve tekst të transmetuara në rrjet nga përdoruesit në kohë reale. Ky shërbim eshte bere upgrade nga platforma Microsoft Lync 2013 ne platformën Microsoft Skype for Bussines 2015 e cila integrohet me shërbimin e postës elektronike duke unifikuar komunikimin elektronik. Sistemi Microsoft Skype for Bussines 2015 është përshtatur për të ofruar dhe shërbimin e telefonisë fikse, pra bën të mundur komunikimin me operatorët e tjerë telefonike.

Infrastruktura e SFB2015 ka një menaxhim të qendërzuar dhe të lokalizuar në zyrat qendrore të AKSHI-t. Ky shërbim do të identifikohet si shërbim enterprise. Ky shërbim ofrohet për te gjitha Ministritë dhe për institucionet me kërkesë të tyre. Numri total i përdoruesve, të cilëve u është implementuar dhe janë konfiguruar për të komunikuar përmes Skype for Bussines 2015 është 3997.

U kryen konfigurimet e plota për Ministrite e Linjës dhe gjithashtu u zhvilluan dhe trajnimet e plota për përdoruesit në institucionet në fjalë.

Gjithashtu është bërë e mundur konfigurimi i mesazheve zanore duke integruar shërbimet e Skype for Bussines me shërbimin e Postës Elektronike.

4.1.4. Instalim automatik dhe qendror i aplikimeve

Nëpërmjet këtij shërbimi është i mundur instalimi i aplikimeve të ndryshme të kërkuara në

kompjuterat të cilët janë në domainin GOV. Në vitin 2016 është mundësuar update i rregullt dhe i sigurt i 2083 makinave klientë dhe 207 makinave server.

Gjithashtu është ofruar instalimi i aplikacioneve Microsoft për këto klientë. AKSHI ofron mundësinë per si zgjidhje per mbrojtjen e klienteve platformen e Symantec Endpoint Protection version 14.0.1. Përsa i përket menaxhimit të antivirusit, gjatë vitit 2016 është mundësuar instalimi në mënyrë të përqendruar e antivirusit Symantec në të gjithë Ministritë e Linjës, Kjo platformë menaxhohet nga Drejtoria e Sigurisë dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Sistemeve.

4.1.5. Licencimi i produkteve Microsoft

AKSHI në kuadër të marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë Microsoft administron licencat dhe shpërndarjen e tyre sipas kërkesave dhe nevojave të institucioneve publike shtetërore.

Duke filluar nga janari 2016 e deri aktualisht janë pajisur me licenca 39 institucione. Numri i licencave të shpërndara për vitin 2016 është **3550**.

4.1.6. Project Server

Microsoft Project është një ndër shumë software të menaxhimit të projekteve, të cilat janë të programuara për të ndihmuar menaxherët/drejtuesit për të patur nën kontroll jo vetëm afatet kohore të realizimit të një plani pune, por dhe burimet njerëzore në detyrat e caktuara, matjen e kohës së punës, menaxhimit të buxhetit, realizim-tejkalim të afateve.

Në kuadër të ndjekjes së ecurisë së planit 600-ditor qeveritar nga ministritë e linjës dhe Kryeministria është ngritur një sistem client <->server i bazuar në Sharepoint dhe Project Server. Në vazhdimësi janë shtuar kolona të reja dhe është përmirësuar procesi i raportimit. Sot në sistem janë rreth 492 përdorues dhe 377 resurse për të gjitha ministritë.



Në ambientet e AKSHI-t, Project Manager përdoret nga:
Drejtoria e Kërkimit dhe Zhvillimit e-Gov, për administrimin me efikasitet të projekteve dhe investimeve të dërguara për miratim nga institucionet e administratës publike, duke mundësuar marrjen dhe shqyrtimin në kohe të tyre, brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 703, datë 29.10.2014 "Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".
Sektorit të Programimit dhe Zhvillimit, për ndjekjen dhe menaxhimin sa më të saktë të projekteve dhe detyrave të ngarkuara.

4.1.7. e-Aktet (mbledhjet e qeverisë paperless)

Gjatë vitit 2016 është zhvilluar administrimi, mirëmbajtja në proceset rutin të aplikimit, duke dhënë suport për userat në të gjithë institucionet parësorë.
Janë krijuar 174 certifikata të nevojshme për përdoruesit miratues në sistem.
Është dhënë suport HelpDesk i nivelit të parë dhe trajnime të vazhdueshme për të gjitha nivelet në 19 institucionet.

Tabelat e mëposhtme japin një panoramë të numrit të materialeve të procesuara për institucion në këtë sistem, ku numri i akteve në total është 1155.



4.1.8. EDRMS

Gjatë vitit 2016 janë kryer ndryshime në sistem. Ndryshimet kane ndodhur si rrjedhojë e propozimeve të NJMLP, të cilat u realizuan në sajë të marrëveshjes dhe parteritetit me Microsoft. Aktualisht sistemi është në process upgrade nga Microsoft SharePoint 2010 në Microsoft SharePoint 2016.

Në vijim të procesit të pilotimit, Kryeministria në ambientin live ka regjistruar 610 shkresa.

Në ambientet e AKSHI-t është duke u pilotuar në ambientin test dhe janë regjistruar 669 shkresa.

4.2. Sektori i Programimit dhe Zhvillimit

Sektori i Programimit dhe Zhvillimit është një sektor i ri i krijuar në strukturën e re, në përmbushje të detyrave të reja të ngarkuara AKSHI-t, në VKM Nr. 703 datë 29.10.2014 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit". Ky sektor zhvillon sisteme informatike në funksion të nevojave të Agjencisë, Kryeministrisë ose institucioneve qeveritare.
Gjatë vitit 2016, sektori është angazhuar në disa projekte të rëndësishme të cilat janë përfunduar ose janë ende në proces. Po ashtu për shkak të ngarkesës dhe kërkesave në rritje për automatizim të proceseve të punës, stafi i këtij sektori në pamundësi të realizimit për shkak të projekteve në proces është angazhuar edhe në projekte të planifikuara për vitin 2016.

Projektet janë si më poshtë:

4.2.1. Sistemi i monitorimit të shkallës së realizimit të angazhimeve të programit të qeverisë - NJMLP

Me kërkesë të NJMLP (Njësia e Monitorimit të Legjislacionit dhe Programeve) në Kryeministri, u kërkua prej AKSHI-t krijimi i një aplikacioni web, i cili shërben për paraqitjen në mënyrë të personalizuar të gjithë angazhimeve qeveritare, përmbushjen dhe monitorimin e tyre ndaj ministrive të linjës. Aplikacioni web nis me identifikimin e përdoruesve në bazë të roleve, nxjerrjen e përdoruesit në hapësirën e punës, nga e cila mund të vijohet me leximin e dokumentit zyrtar publik të Qeverisë, ku përmenden të gjitha angazhimet e saj. Më pas vijohet me shikimin një për një të çdo angazhimi, produktet e çdo angazhimi, komentet dhe përqindjet e realizimit të komunikuara nga çdo institucion përgjegjës dhe kontribues në angazhim, si edhe pasjen e një hapësire pune për punonjësit e Njësisë (NjMLP) me qëllim analizimin më të shpejtë të çdo angazhimi dhe produkti. Pjesa finale e këtij aplikacioni shoqërohet me gjenerimin e raporteve dhe pasqyrave të sakta të gjendjes së përditësuar të çdo angazhimi në veçanti dhe të të gjithë listës së plotë të tyre.

4.2.2. Sistemi i menaxhimit dhe monitorimit të FZHR

FZHR-ja ka kërkuar nga Sektori i Programimit dhe Zhvillimit një sistem që t'i mundësojë menaxhimin e aplikimeve që i dërgohen nga institucione të ndryshme. Këto aplikime vijnë në formë dosjeje, me një strukturë të caktuar. Sistemi duhet të bëjë të mundur që këto dosje të studiohen nga sekretariatet teknike përkatëse, të cilat do të japin një vlerësim në bazë të standardeve të tyre. Më pas dosjet duhet të shikohen nga FZHR-ja, e cila do t'i përcjellë tek Këshilli i Zhvillimit Rajonal, i cili do të zgjedhë cilat janë aplikimet më të mira, të cilat do të financohen. Dosjet që miratohen nga Këshilli do i kalojnë për ndjekje Fondit, i cili do të ndjekë këto projekte deri në përfundimin e tyre. Aplikimi gjithashtu duhet të pranojë dhe ngarkimin e raporteve të ndryshme që do të vijnë nga sekretariatet përkatëse, si dhe raportet që do kërkohen të prodhohen nga vetë sistemi në mënyre periodike. Gjithashtu të gjithë projektet që janë ndjekur nga Fondi duhet të shfaqen në një hartë. Çdo projekt do të jetë i kategorizuar sipas llojit (janë 8 kategori). Çdo kategori do ketë sizmologjinë përkatëse.

4.2.3. eRaport

eRaport është sistemi i cili do përdoret nga kabinetet e Ministrive dhe Kryeministria për të raportuar për mbarëvajtjen e punëve në çdo dikaster. Raportimet janë të bazuara në indikatorët që matin punën e ministrive. Në bazë të këtyre indikatorëve të cilët raportohen në frekuencë të ndryshme ditore, javore, mujore bëhen analiza dhe vendimmarrje të cilat i vlejnë mirëqeverisjes.

4.2.4. eQBZ

Është kërkuar që të konceptohet një bazë të dhënash, ku të ruhen Fletoret Zyrtare të publikuara. Si fillim është bërë konceptimi i modelit që do të ketë kjo bazë të dhënash dhe si do te ruhen këto të dhëna. Më pas do të bëhet popullimi i bazës së të dhënave me të dhënat që zotëron QBZ. Kjo bazë të dhënash do mund të shihet nga publiku me ane të një portali web dhe punonjësit e QBZ-së do e menaxhojnë nga po i njëjti portal.

Sistemi informatik për menaxhimin e botimeve të “Akteve të botueshëm” do të mundësojë hedhjen, kategorizim, përditësimin, botimin në web dhe kërkimin e dokumenteve që sipas ligjit cilësohen si “Akte të botueshëm”.

4.2.5. Menaxhimi i Aseteve të KM

Sistemi informatik për menaxhimin e alokimit të aseteve të Kryeministrisë do të mundësojë menaxhimin sa më efektiv të aseteve ndërmjet procedurës së prenotimit. Sistemi do të jetë i shfrytëzueshëm vetëm nga punonjësit e Kryeministrisë dhe brenda rrjetit qeveritar(GovNet).

4.2.6. Menaxhimi i Automjeteve

Sistemi informatik për menaxhimin e Automjeteve të Kryeministrisë do të mundësojë menaxhimin sa më efektiv të automjeteve ndërmjet procedurës së prenotimit/rezervimit. Sistemi do të jetë i shfrytëzueshëm vetëm nga punonjësit e Kryeministrisë dhe brenda rrjetit qeveritar(GovNet).

4.2.7. Menaxhimi i Ndjekjes së Kontratave

Sistemi informatik për menaxhimin e Njdjekjes së Kontratave do të mundësojë menaxhimin sa më efektiv të ndjekjes së Kontratave. Sistemi do të jetë i shfrytëzueshëm vetëm nga punonjësit e AKSHI-t dhe brenda rrjetit qeveritar(GovNet).

4.2.8. Menaxhimi i Hyrje Daljeve

Sistemi informatik për menaxhimin e Hyrje Daljeve do të mundësojë menaxhimin e prezencës. Sistemi do të jetë i shfrytëzueshëm vetëm nga Burimet Njerëzore të AKSHI-t dhe brenda rrjetit qeveritar(GovNet).

4.2.9. IntraNet

Sistemi informatik për menaxhimin e publikimeve brenda rrjetit qeveritar. Sistemi do të jetë i shfrytëzueshëm nga administrata brenda rrjetit qeveritar(GovNet).

5. DREJTORIA JURIDIKE DHE E STATISTIKAVE E-GOV & TIK

Drejtoria Juridike dhe e Statistikave e-GOV dhe TIK, nën drejtimin e Drejtorit Juridik, ka si mision të saj orientimin dhe ndihmën juridike të çështjeve me karakter juridik që trajtohen në AKSHI dhe në administratën e saj. Në përmbushje të këtij misioni, ajo ushtron detyra të karakterit juridik, organizativ, informues dhe marrëdhënieve me Drejtoritë e tjera. Drejtoria Juridike e përbërë nga dy sektorë, Sektori Juridik dhe Sektori I Integrimit, gjatë vitit 2016 në përmbushje të objektivave të institucionit, ka punuar në disa drejtime kryesore:

- Hartimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor të veprimtarisë së institucionit.
- Përmirësimin, plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e Teknologjisë së Informacionit.
- Kontribut dhe opinion ligjor në përmirësimin e kuadrit ligjor të institucioneve të ndryshme.
- Detyra të tjera.

5.1. Sektori Juridik

Krijon, menaxhon, vepron për të përmirësuar problematikën ligjore të drejtorisë me qëllim rritjen e performancës së saj. Eshtë përgjegjës për materialet me karakter juridik, të cilat janë për shqyrtim në drejtorinë dhe konsulton Drejtorin për të gjithë problematikën ligjore. Gjatë vitit 2016 ka dhënë kontribut në përgatitjen e dokumente me natyrë juridike, në përmirësimin e punës së drejtorisë, si dhe në përpilimin e opinioneve ligjore, duke zbatuar me korrektësi legjislacionin në fuqi.

5.2. Sektori Integrimit dhe Statistikave

Nëpërmjet sektorit të Integrimit dhe Statistikave e—Gov dhe TIK, Drejtoria e Juridike dhe Statistikave e-Gov dhe TIK ndjek procesin e integrimit europian për çështjet e lidhura me shoqërinë e informacionit, ecurinë e sektorit TIK dhe zhvillimeve të qeverisjes elektronike. Gjithashtu kontribuon në përmirësimin e politikave për qeverisjen elektronike dhe shoqërinë e informacionit në tërësi në përputhje me acquis e Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2016, në mënyrë të theksuar, në tërësinë e detyrave të Drejtorisë Juridike, theksojmë si më poshtë vijon:

- Kontributi i dhënë lidhur me hartimin e Ligjit për Qeverisjen Elektronike, si përmbushje e objektivit Nr.3 *"Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për eqeverisjen dhe Shoqërinë e Informacionit" e prioritetit të parë strategjik "Politika për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimi i shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset" të strategjisë ndërsektoriale "Axhenda dixhitale e Shqipërisë 2005-2020".*
- Kontribut në hartimin e VKM- së Nr. 755 datë 26.10.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, *"Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* e finalizuar me miratimin e tij nga Këshilli i Ministrave dhe publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 205 datë 03.11.2016.

- Realizimi i fushatës sensibilizuese për njohjen dhe informimin publik kombëtar me sistemin multifunksional të Lejeve të Ndërtimit, nëpërmjet prodhimit dhe transmetimit të një spotit promovues të transmetuar në mediat televizive.
- Përshtatja e Kontratës së Punës, ku rregullohen marrëdhëniet e punës e cila përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve, në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit Nr.59 datë 23.04.2015 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".
- Ndjekja e procedurave ligjore (gjyqësore dhe përmbarimore) të institucionit.
- Realizimin e procedurave të prokurimit të finalizuara me nënshkrimin e kontratave përkatëse 5 projekte të financuara nga Buxheti i Shtetit.
- Kontributi i dhënë lidhur me ndjekjen e "Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015 – 2020", si dhe "Dixhitalizimin dhe e-qeverisjen" në kuadër të reformës së qeverisë shqiptare "Për Menaxhimin e Integruar të Politikave në Fushën e Mirëqeverisjes dhe Administrimit Publik".

5.3. Sektori Juridik

Jetësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor të veprimtarisë së institucionit.

- Dhënia e një sigurie juridike dhe ligjore në lidhje me zbatimin e materialeve të ndryshme juridike.
- Dhënia e mendimeve dhe kontributeve për sa i përket punës së përditshme të AKSHI-t, veprimtarinë e saj dhe interpretime ligjore për subjekte të tjera (me të tretë) për sa i përket fushës së teknologjisë së informacionit.
- Përfaqësimi i Institucionit në proceset e ndryshme gjyqësore në të cilat kemi qenë palë e paditur.
- Kulturë profesionale të ruajtjes së sekretit dhe konfidencialitetit nga ana e punonjësve.
- Krijimi i një plani të posaçëm trajnimi dhe azhurnimi për të gjithë punonjësit e Drejtorisë të cilët i përkushtohen procesit të rifreskimit të kuadrit legjislativ.

<u>Projekti</u> - Hartimi i Projekt Ligjit të ri për Qeverisjen Elektronike.

Hartimi i Ligjit për qeverisjen elektronike, si përmbushje e objektivit Nr.3 *"Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për e-qeverisjen dhe shoqërinë e informacionit"* e prioritetit të parë strategjik "Politika për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimi i shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset" të strategjisë ndërsektoriale "Axhenda dixhitale e Shqipërisë 2005-2020".

- Hartimi i një ligji të ri "Për Qeverisjen Elektronike" do të unifikojë qasjen e deritanishme ndaj fenomenit evolutiv që është Shoqëria e Informacionit.

- Projektligji i qeverisjes elektronike do të mirëpërcaktojë rregulla mbi interoperabilitetin, mbi protokollin elektronik, arkivin elektronike, shërbimet e qeverisjes elektronike etj.;
- Përafrimi me standardet dhe praktikat më të mira evropiane është një tjetër aspekt që do të adresojë projektligji për qeverisjen elektronike. Në këtë kuadër ligji i ri vjen në adresim dhe përmbushje të detyrimeve që lindin nga neni 70 dhe 103 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Gjithashtu, projektligji ka për qëllim përafrimin e akteve ligjore te Bashkimit Evropian, konkretisht përafrimin me burime parësore dhe dytësore të legjislacionit të BE-së. Projektligji i qeverisjes elektronike ka për qëllim përafrimin me Axhendën Dixhitale të BE-së, si dhe Strategjinë Tregu i Vetëm Dixhital, dokumente bazë në fushën e qeverisjes elektronike në Bashkimin Evropian.

Ndër të tjera e-qeverisja adreson nevojën për:

- bashkëpunim ndërmjet sektorëve të administratës publike me qëllim krijimin e shërbimeve publike;
- shkëmbim të informacionit midis sektorëve të administratës publike për të përmbushur kërkesat ligjore apo angazhimet politike;
- ndarjen dhe ripërdorimin e informacionit midis sektorëve të administratës publike për të rritur efikasitetin administrativ.

Rezultati është:

- ofrimi i përmirësuar i shërbimeve publike për qytetarët dhe bizneset;
- kosto më të ulëta për administratat publike, bizneset dhe qytetarët për shkak të ofrimit efikas të shërbimet publike.

Projekti - Hartimi i VKM- së Nr. 755 datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit" e finalizuar me miratimin e tij nga Këshilli i Ministrave dhe publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 205 datë 03.11.2016.

Projekti - Realizimi i fushatës sensibilizuese për njohjen dhe informimin publik kombëtar me sistemin multifuknional të Lejeve të Ndërtimit. Bazuar në shkresën e Ministrisë së Zhvillimit Urban Nr. Prot. 1135 datë 22.02.2016 mbi nevojën e realizimit të një fushate sensibilizuese për njohjen dhe informimin publik kombëtar me sistemin multifuknional të Lejeve të Ndërtimit, u hartua dhe realizua procedura me objekt “Sistemi Multifunksional i Lejeve të Ndërtimit” qëllimi i së cilës ishte *Njohja dhe informimin publik kombëtar me Sistemin Multifunksional të Lejeve Ndërtimit*, nëpërmjet prodhimit dhe transmetimit të një spotit promovues të transmetuar në mediat televizive.

Kontribut dhe opinion ligjor në përmirësimin e kuadrit ligjor të institucioneve të ndryshme.

Në kuadrin e përmirësimit të legjislacionit si dhe të përmbushjes së objektivave të përcaktuara për Drejtorinë është dhënë kontribut dhe opinion në aktet nënligjore të mëposhtme:

- Është dhënë kontribut dhe opinion për Projektvendimet e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, konkretisht:

1. "Për krijimin e bazës Shtetërore për sistemin e shërbimeve të punësimit". Projektvendimi, në zbatim të Ligjit Nr.10325 "Për bazën e të dhënave shtetërore", synon të realizojë krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Shërbimeve të Punësimit. Objektivi i këtij projektvendimi është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore, duke siguruar dhe ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave shtetërore.

2. "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të kontributeve (CMIS)". Ky projektvendim synon të përcaktojë rregullat e funksionimit të bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të kontributeve.

3. "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të arkivimit dhe menaxhimit të dokumentave(DMAIS)". Ky projektvendim synon të përcaktojë rregullat e funksionimit të bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të arkivimit dhe menaxhimit të dokumenteve.

4. "Për krijimin e bazë së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të kalkulimit dhe pagesës së përfitimit (PCAMS)". Ky projektvendim synon të përcaktojë rregullat e funksionimit të bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të kalkulimit dhe pagesës së përfitimit.

- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektstrategjinë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes "Për miratimin e strategjisë kombëtare për pronësinë intelektuale 2016-2020". Kjo projektstrategji ka si qëllim të miratojë Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2025, si një dokument i rëndësishëm politik i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për forcimin e sistemit të Pronësisë Intelektuale në vend.

- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektvendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Policisë së Shtetit, për menaxhimin elektronik të gjobave, (E-gjoba)". Ky projektvendim synon të përcaktojë krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Policinë e Shtetit, përcaktimin e funksioneve kryesore të bazës së të dhënave për sistemin e menaxhimit elektronik të gjobave" (E-gjoba), duke mundësuar nëpërmjet këtij sistemi automatizimin e procesit të administrimit të gjobave.

- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektligjin "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9880 datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik", i ndryshuar".

- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektligjin "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara".

- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektligjin "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik".

- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektligjin "Për sigurinë kibernetike".

- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile", të ndryshuar.
- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektligjin e Ministrisë së Zhvillimit Urban "Për strehimin social".
- Është dhënë kontribut dhe opinion mbi projektligjin e Ministrisë së Punëve të Brendshme "Për shërbimin e Sigurisë së Personaliteteve të larta Shtetërore". Projektligji ka për qëllim caktimin e rregullave për shërbimin e sigurisë së Personaliteteve të larta shtetërore dhe të objekteve me rëndësi të veçantë.
- Është dhënë kontribut për hartimin e rregullores së Këshillit të Ministrave për rezervimit e sallave dhe automjeteve zyrtare, përmes krijimit të portalit të mënaxhimit të aseteve. Asete.kryeministria.al është sistemi i cili ju vjen në ndihmë drejtorëve të departamenteve të kryeministrisë për të rezervuar salla dhe automjete.
- Plotësimi dhe depozitimi, brenda datës 05.05.2016, i formularëve të vetëdeklarimit të drejtuesve të çdo niveli në AKSHI, të cilët nuk përfshihen në shërbimin civil sipas përcaktimeve të shkoronjës "gj", pika 4, kreu II I vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
- Ndjekje e detyrave të ngarkuara dhe bashkëpunim me strukturat e tjera të AKSHI-it për përmbushjen e detyrave;

Nga ana tjetër me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe forcimit të kapaciteteve të sektorit juridik, përgjatë vitit 2016 janë kryer trajnimet dhe është marrë pjesë në eventet e mëposhtme:

- Tryezë diskutimi për Projektligjin "Për Sigurinë Kibernetike", "Mbi prezantimin e projektligjit "Për Sigurinë Kibernetike", në datë 23.05.2016.
- Trajnim për koordinatorët e të drejtës së informimit, prezantim i portalit pyetshtetin.al, në datë 29.04.2016.
- Takim konsultues mbi aktet nënligjore të Ligjit Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", në datë 05.09.2016.
- Janë ndjekur prezantimet dhe trajnimi për "Kodin e ri të Procedurave Administrative" zhvilluar në datat 19-21 shtator 2016.
- Është ndjekur Samiti i Parë i Diasporës Shqiptare "*Të pandarë për Shqipërinë*", në panelin e organizuar "*Të ndërtojmë Rrjetin Ndërshqiptar të Aftësive*", në datë 19 Nëntor 2016.

Procedurat ligjore (gjyqësore dhe përmbarimore) të institucionit.

1.4. Sektori i Integrimit dhe Statistikave e-GOV dhe TIK

Sektori i Integrimit dhe Statistikave e-Gov dhe TIK në zbatim të rregullores së brendshme të AKSHI-t, përgjatë vitit 2016 ka realizuar detyrat e mëposhtme:

Praktikat e Integrimit

- Progres Raporti 2016;
- Përditësimi i Planit Kombëtar i Integrimit Evropian 2017-2020;
- Nënkomiteti Inovacioni Shoqëria Informacionit dhe Politikat Sociale;
- Komiteti i Stabilizim-Asociimit (KSA);
- Ndjekjet, koordinimin raportimin në Takimit e Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike;

Me qëllim kontribuimin për **Progres Raportin** e Qeverisë Shqiptare në kuadër të raportimit në strukturat e Komisionit Evropian, sektori i Integrimit dhe Statistikave ka hartuar dokumentet e mëposhtme:

- Përgjatë muajit **prill 2016** është hartuar kontributi i parë për Progres Raportin 2015 lidhur me kapitullin 10 të *acquis* së Bashkimit Evropian,
- Në periudhën **korrik-gusht 2016** është hartuar edhe kontributi i dytë për Progres Raportin 2016 lidhur me kapitullin 10 të *acquis* së Bashkimit Evropian.

Kontributi ka përfshirë raportime gjashtëmujore respektivisht për periudhat *shtator 2015 - Prill 2016* dhe *Maj-Shtator 2016* dhe është fokusuar në progresin e arritur nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në kuadër të implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit veçanërisht përsa i përket zbatimit të legjislacionit dhe zhvillimeve të fushës së qeverisjes elektronike.

Sektori i Integrimit dhe Statistikave e-GOV dhe TIK ka kontribuar në koordinimin dhe raportimin tremujore përgjatë vitit 2016 mbi Progresin e realizueshmërisë së Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020, për Kapitullin 10 "Shoqëria e Informacionit dhe Media" për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Sektori i Integrimit dhe Statistikave ka hartuar kontributin e AKSHIt në kuadër të takimit të tetë të nën komitetit për "Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikat Sociale" të zhvilluar në muajin prill 2016. Gjithashtu, në këtë kuadër sektori i Integrimit dhe Statistikave e-Gov dhe TIK ka raportuar në strukturën e përbashkët BE-Shqipëri të mbajtur në Tiranë, duke përcjellë zhvillimet më të fundit në këtë fushë gjatë vitit 2016 në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Përgjatë vitit 2016, Sektori i Integrimit dhe Statistikave e-Gov dhe TIK ka ndjekur dhe koordinuar kontributin e AKSHIt **për Komitetin e Stabilizim-Asociimit (KSA),** si struktura më e lartë dypalëshe BE-Shqipëri. Për këtë qëllim është hartuar kontributi njëvjeçar mbi zhvillimet më të fundit në

implementimin e politikave të qeverisjes elektronike në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Gjithashtu, përgjatë vitit 2016, Sektori ka dhënën një kontribut të veçante për **Grupin e Posaçëm për Reformën në Administratën Publike.** Në këtë kuadër është hartuar kontributi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit mbi zhvillimet më të fundit në fushën e qeverisjes elektronike, sfidat, arritjet dhe planet për të ardhmen janë pasqyruar në këtë material për periudhën shtator 2015 - janar 2016.

Lidhur me përafrimin e legjislacionit

Përgjatë periudhës njëvjeçare, sektori i Integrimit dhe Statistikave ka dhënë kontribut në përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet dhe kërkesat që paraqet *acquis* e Bashkimit Evropian për fushën e Shoqërisë së Informacionit. Në këtë këndvështrim Sektori i Integrimit dhe Statistikave e-Gov dhe TIK ka analizuar projekt aktet ligjore si vijon:

- Analizë ligjore mbi projektligjin e qeverisjes elektronike;
- Analizë ligjore mbi projektligjin për ripërdorimin e informacionit publik
- Analizë mbi projekt VKM për vlefshmërinë ligjore të dokumentit administrativ të gjeneruar nga portali unik qeveritar e-Albania;

Sektori gjatë vitit 2016, ka raportuar për zbatimin e **Planit të Veprimit të Strategjisë Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020,** duke dhënë një informacion të detajuar lidhur me zbatimin e aktiviteteve me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara në këtë Plan Veprimi nga ana e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dhe të dhëna mbi kostot financiare të alokuara për këto aktivitete. Në kuadër të procesit të raportimit për përditësimin e Planit të Veprimit janë zhvilluar takime me përfaqësues te Ministrit të Shtetit për Shoqërinë e Inovacionit dhe Administratës Publike.

Gjithashtu, stafi i sektorit ka ndjekur në vijimësi raportimet për **Strategjinë Ndërsektoriale Reforma në Administratën Publike**, duke marrë pjesë aktive në raportim pranë MIAP, hartim dhe koordinim të kontributit vjetor dhe tremujor të AKSHI-t për këtë qëllim, si dhe ndjekjen e planit të veprimit të kësaj strategjie.

Një tjetër angazhim, përgjatë vitit 2016 për sektorin e Integrimit dhe Statistikave e-Gov dhe TIK ka qënë edhe koordinimi dhe raportimi në kuadër të **Strategjisë Ndërsektoriale** dhe **Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2015-2017**. Për këtë qëllim është koordinuar dhe hartuar kontributi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijim të angazhimeve të ndërrmarra në këtë plan veprimi.

Stafi i Sektorit të Integrimit dhe Statistikave e-Gov dhe TIK gjatë vitit 2016 ka koordinuar punën për raportimin lidhur me rishikimin dhe konsolidimin e planit operacional të punës 2016 -2017 të Ministrit të Shtetit për Shoqërinë e Inovacionit dhe Administratës Publike, për sa I përket aktiviteteve referuar Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Inovacionit.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 129, mbi ngritjen e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), konkretisht të Mirëqenies dhe Administrimit Publik, Sektori i Integrimit dhe

Statistikave e-GOV dhe TIK ka marrë pjesë në mbledhjet e organizuara nga MIAP në funksion të këtij Grupi.

Gjithashtu Sektori i Integrimit dhe Statistikave e-GOV dhe TIK ka shërbyer si sekretariat brenda Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për organizimin dhe koordinimin e punës për zhvillimin e katër mbledhjeve të **Grupit Tematik Dixhitalizmi dhe e-Qeverisja,** si nën strukturë e GMIP Mirëqeverisja dhe Administrimi Publik. Është koordinuar ngushtësisht me drejtoritë e tjera në AKSHI dhe përfaqësues të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, për trajtimin e çështjeve të diskutuara në këto takime.

Gjatë vitit 2016, Sektori i Integrimit dhe Statistikave e-GOV dhe TIK ka marrë pjesë në aktivitete, workshop-e dhe konferenca si më poshtë vijon:

- Pjesëmarrje në Workshop-in "Albania ICT Centric Country Review", Tiranë
- Pjesëmarrje në Workshop-in e TAIEX "On the Re Use of Public Sector Information", lidhur me ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, parë në këndvështrimin e Direktivës së BE-së, referuar parimeve të Direktivës, detyrimeve të saj dhe politikave të vendeve anëtare të BE-së.
- Pjesëmarrje në Konferencën Rajonale "Better Regulation and Competitiveness", në Bograd, lidhur me ecurinë mbi sistemin rregullator dhe konkurrencën në rajon, si dhe ndryshimet në hartim legjislacioni dhe politikë-bërje për përmirësimin e këtyre sistemeve kundrejt standardeve dhe integrimit Europian.

Lidhur me Statistikat

Me qëllim ngritjen dhe fuqizimin e sektorit të Statistikave, është aplikuar pranë strukturave të Komisionit Evropian për tu njohur me praktikat evropiane për këtë fushë.

Eshtë vazhduar me bashkëpunimin ndërinstitucional lidhur me koordinimin dhe matjen e indikatorëve të Strategjise Axhenda Dixhitale, matjen e shërbimeve publike bazë për qytetarët që janë plotësisht online sipas standardeve evropiane, si dhe periodiciteti i raportimeve nën Strategjinë Axhenda Dixhitale. Në këtë kuadër janë zhvilluar takime me përfaqësues të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike.

Nga ana tjetër me qëllim rritjen e profesionalizimit dhe forcimit të kapaciteteve të sektorit të Integrimit dhe Statistikave e-Gov dhe TIK përgjatë vitit 2016 stafi i këtij sektori ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga INSTAT "Programi pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare 2017-2020", i cili përcakton parimet, standardet në lidhje me prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, si dhe prioritetet, objektivat strategjike, planet dhe format e ndërveprimit, bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim plotësimin e nevojave të brendshme për vendimmarrjen dhe monitorimin e politikave por edhe plotësimin e detyrimeve të Shqipërisë në përmbushjen e kërkesave të acquis communitaire në fushën e statistikave.

Sektori i Statistikave e-Gov dhe TIK ka identifikuar dhe hartuar projektin për indikatorët e identifikuar të cilët vijnë në përputhje me indikatorët mbi shërbimet bazë elektronike që maten në Bashkimin Evropian "e-Government Benchmark Method, an update for a neë circle 2016-2019", dhe të parashikuar në Strategjinë Agjenda Digjitale.

2. DREJTORIA E KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT e-GOV

Më poshtë paraqitet një informacion i përmbledhur në lidhje me punët e realizuara gjatë vitit 2016 nga Drejtoria e Kërkimit dhe Zhvillimit e-Gov.

Funksionet kryesore të drejtorisë janë zhvillimi i qeverisjes elektronike nëpërmjet modernzimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve që ofrohen nga administrata publike, bazuar në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, monitorimi i implementimit të tyre si dhe koordinimi i projekteve dhe trajtimi i investimeve në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit TIK në administratën publike për të shmangur realizimin e investimeve të dubluara.

Puna e drejtorisë është e ndarë sipas tre sektorëve:

- Sektori i Kërkimit dhe Hartimit të Projekteve
- Sektori i Menaxhimit të Investimeve në TIK
- Sektori i Standardeve TIK dhe Implementimit të Projekteve

6.1. Investime në fushën TIK për vitin 2016

6.1.1. Hartimi i Standardeve TIK

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.703, datë 29.10.2014, "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", pika 3, përcaktohet se një nga detyrat kryesore të AKSHI-t është përcaktimi i standardeve TIK që do të përdorin Kryeministria, ministritë dhe institucionet në varësi të Kryeministrisë dhe ministrive të linjës. Kjo konsiston në hartimin e Specifikimeve Teknike, të cilat aplikohen nga njësia e përqëndruar në interes të institucioneve të cilat kanë të parashikuara shtim të kapaciteteve teknike.
Specifikimet Teknike per vitin 2017 janë përpiluar, duke respektuar ligjet e konkurrencës së lirë dhe duke mos kufizuar apo favorizuar operatorët e ndryshëm në treg, por njëkohësisht edhe duke mbajtur një nivel të lartë të cilësisë së pajisjeve që blihen për nevojat e administratës. Standardet janë hartuar nën sugjerimet dhe takimet e shpeshta me grupet e interesit të cilat operojnë në tregun tonë.
Këto standarde kanë rezultuar të efektshme jo vetëm teknikisht por dhe financiarisht, fakt ky që ka mundësuar mbështetje dhe nga biznesi privat, i cili ligjërisht nuk është i detyruar t'i zbatojë.

6.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekteve të TIK

Për të siguruar zbatimin e standardeve në fushën TIK si dhe për të shmangur dublikimin e investimeve publike dhe mbivendosjen e projekteve TIK, AKSHI shqyrton projektet e fushës TIK të institucioneve të administratës publike sipas përcaktimeve të VKM Nr. 703, datë 29.10.2014 "Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" dhe Udhëzimit Nr. 2 datë 2.09.2013 "Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në administratën publike". Këto projekte trajtohen si në aspektin teknik, ashtu dhe në atë funksional, duke analizuar koston financiare të domosdoshme për këtë projekt, në përputhje me standardet teknike të përcaktuara si dhe në një vështrim strategjik përcaktohet efektshmëria që ky investim ka në vijueshmëri.



Fig.1 Numri i projekteve në fushën TIK të miratuara me vlerat përkatëse (në €)

për periudhën 2010-2016

Gjatë vitit 2016 janë trajtuar **181 praktika** të institucioneve të Administratës Publike për projekte të reja, shtesa të projekteve ekzistuese, mirëmbajtje të sistemeve si dhe përmirësim të infrastrukturave ekzistuese, **150** prej të cilave janë miratuar nga AKSHI, pa përfshirë këtu praktikat e AKSHI-t. Krahasuar me vitin 2015 janë miratuar 12 projekte më shumë (pra rritje e numrit të projekteve afërsisht me 9%) me një vlerë 12 % më të ulët se viti 2015.

Përsa i përket praktikave të tjera:

- **19** projekteve u është dërguar shkresa me komente dhe nuk ka ardhur përgjigjia me komentet e reflektuara nga institucionet përkatëse
- **8** projekte nuk janë objekt shqyrtimi i AKSHI-t
- **4** projekte janë refuzuar

Më poshtë do të gjeni të pasqyruar shpërndarjen e investimeve sipas projekteve:

- Zhvillim Sistemesh të reja (**45** projekte)
- Mirëmbajtje e Sistemeve dhe pajisjeve Hardware (**10** projekte)
- Blerje pajisjesh Hardware (**95** projekte)



Fig.2 Shpërndarja e investimeve për vitin 2016 sipas llojit të projekteve

Fondet Buxhetore, për projektet e miratuara nga AKSHI, për investimet në TIK për vitin kalendarik 2016 arrijnë në vlerën **3,695,114,203.79 lekë pa TVSH** (me kursin e këmbimit 140 afersisht **€ 26,393,672.88**)

Në figurën e mëposhtme (Fig.3) jepen statistika mbi statusin e projekteve TIK për vitin 2016.

Nga **150 projekte të miratuara**, numri i projekteve që kanë ardhur më shumë se një 1 (një) herë ka qenë 91 dhe numri projekteve të miratuara direkt ka qenë 59.



Fig.3 Statistika mbi statusin e projekteve TIK për vitin 2016

6.2. Projektet kryesore të trajtuara nga AKSHI në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Ministria e Financave

Gjatë vitit 2016, AKSHI ka kontribuar në hartimin e Termave të Referencës së disa projekteve të rëndësishëm të Ministrisë së Financave. Ndër projektet kryesore është investimi me objekt ***"Blerje pajisjesh për Disaster Recovery Centre të sistemit të thesarit"***. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti ishte ndërtimi dhe funksionimi i një *site*-i të tretë për sistemin SIFQ, e quajtur Disaster Recovery Center. Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti u mundësua: blerja e pajisjeve hardware të nevojshme në të cilat u instalua dhe aktualisht është funksional sistemi SIFQ, si dhe sinkronizimi në kohë reale i *site*-t të tretë (DRC) me *site*-n primar, duke siguruar funksionimin e sistemit SIFQ në çdo kohë dhe ruajtjen e të dhënave të tij.

Gjithashtu, në kuadër të funksionimit online të Sistemit të Thesarit dhe komunikimit të sigurt elektronik midis Ministrisë së Financave dhe degëve në varësi, AKSHI ka dhënë kontributin e tij në hartimin përfundimtar të termave të referencës për projektin me objekt **"Shërbimi LAN/WAN dhe internet i MF**. Objektivi kryesor i projektit ishte ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimit LAN/WAN dhe Internet të Ministrisë së Financave. Implementimi i projektit siguroi lidhjen data dhe komunikim online dhe të sigurt të degëve të thesarit në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Shëndetësisë

Gjatë vitit 2016, AKSHI ka kontribuar në hartimin e Termave të Referencës së një projekti të rëndësishëm të Ministrisë së Shëndetësisë. Ky projekt është investimi me objekt ***"Sistemi i Integruar për Shërbimin e Ri Kombëtar të Urgjencës"***. Institucioni përfitues i drejtpërdrejtë i këtij projekti është Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM). Ndërtimi i një sistemi plotësisht të integruar të urgjencës mjekësore kombëtare, krijimi i një infrastrukture teknologjike me qëllim plotësimin dhe përmirësimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor, si edhe pajisja me një numër të caktuar tabletash për të iniciuar përdorimin e një metode të re komunikimi midis qendrës dhe filialeve, e rendisin përmirësimin e infrastrukturës së këtij sistemi ndër investimet më të rëndësishme, që synon të ndikojë në:

- rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor
- rritjen e bashkëpunimit midis punonjësve të Qendrës Kombëtare të Urgjencës dhe qendrave shëndetësore në të gjithë vendin,
- përmirësimin e efektivitetit të punës,
- rritjen e produktivitetit të përdorimit të sistemeve informatike.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

AKSHI gjithashtu ka kontribuar në hartimin e Termave të Referencës së projektit me objekt **"Ngritja e nje sistemi informacioni për administrimin e integruar të shërbimeve sociale në Shqipëri dhe infrastrukturës hostuese, ku përfshihet edhe mirëmbajtja për 4 vjet"** në bashkëpunim me ekspertët e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, duke mundësuar bërjen efektiv të fondit**.** Nëpërmjet implementimit të këtij projekti mundësohet realizimi i misionit të Programit të Mbrojtjes Sociale dhe

një nga misionet bazë të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ai i "mbrojtjes dhe përfshirjes sociale", duke ndërtuar një sistem informacioni për Administrimin e Shërbimit të Kujdesit Shoqëror në të gjitha nivelet (lokal, rajonal dhe qëndror) dhe i integruar në platformën e aplikimeve të Shërbimeve Sociale.

Ministria e Punëve të Brendshme

Një tjetër projekt i rëndësishëm është edhe ***"Dixhitalizimi i Arkivave"*** i realizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, për të cilin gjithashtu AKSHI në bashkëpunim me ekspertët e institucionit ka dhënë kontributin e tij në hartimin përfundimtar të termave të referencës duke mundësuar bërjen efektive të fondit. Dixhitalizimi i regjistrave, librave të akteve të arkivës së Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile lindi si nevojë e informatizimit total të këtij sektori për të pasur rezultate konform standardeve europiane. Gjithashtu, një qëllim i rëndësishëm për t'u përmbushur si pjesë e këtij projekti është ngritja e infrastrukturës qendrore dhe vënia në punë e sistemit të Arkivave për administrimin e informacionit në format dixhital nga zyrat e gjendjes civile.

AKSHI gjithashtu ka kontribuar në hartimin e Termave të Referencës së projektit me objekt **"Ndërtimi i ndërfaqes së komunikimit ndërmjet RKGJC dhe RKA",** duke mundësuar bërjen efektiv të fondit. Nëpërmjet implementimit të këtij projekti bëhet i mundur finalizimi i shkëmbimit të të dhënave ndërmjet Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, Regjistrit Kombëtar të Adresave si dhe Regjistrit të Emigrantëve. Gjithashtu, do të bëhet e mundur krijimi i një infrastrukture të teknologjisë së informacionit, e cila të sigurojë mbajtjen, sinkronizimin e këtyre komunikimeve dhe të rrisë performancën gjatë shkëmbimit të të dhënave.

Ministria e Drejtësisë

Një kontribut mjaft të rëndësishëm AKSHI në bashkëpunim me ekspertët e institucionit ka dhënë në hartimin përfundimtar të termave të referencës për projektin e realizuar nga Ministria e Drejtësisë me objekt ***"Përmirësim, Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Regjistrit Noterial Shqiptar për një periudhe 2 (dy) vjeçare".*** Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi dhe azhornimi i komponentëve të sistemit RNSH me qëllim mundësinë e integrimit në të ardhmen me databaza të tjera shtetërore, si dhe mirëmbajtja e tij për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

Një tjetër projekt i spikatur për nga rëndësia, është investimi me objekt ***"Administrimi Elektronik i të dhënave për Pronat Shtetërore, të dhënat e Zonave Ekonomike dhe Informatizimi i Shërbimeve për Pronat Shtetërore"***. Përmes këtij projekti synohet të ndërtohet një sistem informatik për administrimin e aseteve shtetërore siç janë:

- administrimi i objekteve shtetërore që do të privatizohen
- administrimi i objekteve shtetërore të dhëna me qira
- administrimi i shoqërive shtetërore
- administrimi i shoqërive në likuidim si dhe administrimi i Zonave Teknologjike të Zhvillimit Ekonomik

Pjesë e këtij projekti është edhe publikimi i të gjithë këtyre aseteve në portalin pronatshtetërore.gov.al

Gjithashtu AKSHI ka dhënë kontributin e tij në hartimin përfundimtar të termave të referencës për një tjetër projekt të kësaj Ministrie, ***"Implementimi i Sistemit Informatik për Rregjistrimin e Sipërmarrjeve në fushën e Turizmit dhe Analizën e të Dhënave.***
Ndërtimi i kësaj databaze do të sjellë lehtësi në përpunimin e informacioneve të lidhura sipërmarrjet në fushën e turizmit dhe një manaxhim më të lehtë dhe të shpejtë të tyre.

Ky investim do të ndikojë në:

- Krijimin e një rregjistri elektronik të sipërmarrjeve në fushën e Turizmit;
- Rritjen e transparencës me palët e interesuara;
- Monitorimin në kohë reale nga ana e Ministrisë të treguesve të performancës (KPI) për secilën sipërmarrje;
- Shkurtimin e kohës së zgjidhjes së problematikave që mund të hasen;
- Rritjen e bashkëpunimit dhe ndarjen e barabartë të punës midis specialistëve.

Ministria e Kulturës

AKSHI gjithashtu ka dhënë kontributin e tij për hartim përfundimtar të termave të referencës për projektin **"Digjitalizimi i shërbimeve të ofruara nga Instituti i Monumenteve të Kulturës".** Për të shmangur problemet teknike, nëpërmjet implementimit të këtij projekti, i gjithë informacioni do te ruhet në një server, i cili do ti vijë në ndihmë të gjithë punonjësve. Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit të brendshëm mbështet dhe punën e platformës e-Leje.

Ministria e Zhvillimit Urban

AKSHI gjithashtu ka kontribuar në hartimin e Termave te Referencës së projektit me objekt ***"Sistemi Informatik i Integruar për Licensimin Profesional të Individëve dhe Subjekteve Juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit"*** në bashkëpunim me ekspertet e Ministrisë së Zhvillimit Urban, duke mundësuar bërjen efektiv të fondit. Përmes këtij projekti synohet:

- ofrimi online i aplikimeve për licensimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike dhe publikimi i këtyre shërbimeve elektronike në portalin qeveritar **e-albania**
- përmirësimi i shërbimeve në lidhje me licensimin profesional
- ndërtimi i aplikacioneve software për e-Shërbimet

Ministria e Energjisë dhe Industrisë

I rëndësishëm per t`u përmendur është edhe bashkëpunimi i AKSHI-t me ekspertët e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për hartimin e Termave të Referencës për projektin me objekt **"Implementimi i Sistemit Informatik per Administrimin dhe Automatizimin e Proceseve ne MEI.**
Ky projekt konsiston në krijimin e një sistemi informatik të integruar për administrimin e çështjeve dhe proceseve administrative në fushat përgjegjëse të Ministrisë së Energjisë, në përputhje me procedurat ligjore. Nëpërmjet implementimit të tij synohet rritja e transparencës për palët e interesuara si dhe rritja e performancës dhe cilësisë së punës së stafit të ministrisë.

Agjencia e Prokurimit Publik

Gjithashtu AKSHI ka dhënë kontributin e tij në hartimin përfundimtar të termave të referencës për projektin me objekt ***"Riinxhinierim dhe shtim funksionalitetesh / shërbimesh në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re"***, duke mundësuar bërjen efektiv të fondit. Qëllimi i këtij projekti është dhënia e një perceptimi të ri për Sistemin e Prokurimit Elektronik duke përmirësuar performancën e sistemit dhe duke ofruar shërbime të reja.

Agjencia e Prokurimit Publik përmes këtij projekti synon:

- Riinxhinierimin e strukturës së të dhënave dhe ngritjen e platformës aktuale të sistemit në versionet më të reja, me qëllim rritjen e performancës së Sistemit të Prokurimit Elektronik.
- Shtimin e shërbimeve elektronike në portalin qeveritar **e-albania** për rritjen e transparencës dhe njoftimin e përdoruesve për llojet e tenderave që publikohen.
- Krijimin e një sistemi ''Business Intelligence'' për raportime dhe analiza komplekse.
- Monitorimin e sistemit me Audit Vault.
- Automatizimin e regjistrave të parashikimeve dhe realizimeve

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

Gjithashtu gjatë këtij viti, AKSHI ka kontribuar në hartimin e Termave të Referencës për projektin me objekt ***"Regjistri i koncesioneve/ partneritetit publik privat"*** duke bërë efektiv fondin. Implementimi i këtij projekti synon krijimin e Rregjistrit Elektronik për kontratat e Koncensionit dhe Partneritetit Publik Privat (REKP), për të regjistruar, raportuar dhe administruar të dhënat e koncesioneve dhe partneritetit publik privat (PPP).

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Një tjetër projekt i spikatur për nga rëndësia, është investimi me objekt ***"Aplikacioni Web për kartelat e të dënuarve dhe personelit"***.

Ky projekt konsiston në:

- Krijimin e një programi që ka për qëllim njohjen e gjendjes së të dënuarve në kohë reale në të gjithë vendin
- ndërtimin e një aplikacioni ''web-based'' për të lehtësuar aksesimin e databazës nga të gjithë nivelet e userave
- ndërtimin e një rrjeti web-VPN për të lidhur DPB me të gjitha I.E.V.P
- ndërtimin e moduleve që kanë të bëjnë me menaxhimin e të dënuarve dhe personelit

Të gjitha mësipër e rendisin përmirësimin e infrastrukturës së këtij sistemi ndër investimet më të rëndësishme të kësaj drejtorie.

Drejtoria e Përgjithshme Detare

AKSHI gjithashtu ka kontribuar në hartimin e Termave te Referencës së projektit me objekt ***"Dixhitalizimi/indeksimi dhe integrimi i regjistrave të drejtorisë së përgjithshme detare"*** në

bashkëpunim me ekspertet e Drejtorisë së Përgjithshme Detare, duke mundësuar bërjen efektiv të fondit.

Përmes këtij projekti synohet të mundësohet dixhitalizimi/ indeksimi dhe integrimi i regjistrave të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, si edhe realizimi i një sistemi të integruar (regjistër elektronik) për përpunimin e arkivës së kësaj drejtorie. Ky sistem do të rrisë shkallën e sigurisë, efikasitetin e kërkimit, monitorimit dhe përpunimit të informacionit.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

AKSHI gjithashtu ka kontribuar në hartimin e Termave të Referencës së projektit me objekt ***"Specifikimet teknike për Shërbimin e Trasmetimit të të Dhënave"***.

Me anën e këtij projekti institucioni do të sigurojë një rrjet të qëndrueshëm dhe të sigurt, për transmetimin e të dhënave on-line. Ky rrjet do të ketë mbulim në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

AKSHI gjithashtu ka kontribuar në hartimin e Termave të Referencës së projektit me objekt ***"Shërbimi i Mirëmbajtjes së sistemit të pajisjeve fiskale"*,** në bashkëpunim me ekspertet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke mundësuar bërjen efektiv të fondit**.**

Sistemi i pajisjeve fiskale administron regjistruesit elektronik fiskal, që instalohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga Shoqëritë e Autorizuara. Qëllimi i këtij projekti ishte mirëmbajtja e sistemit në çdo komponent të tij, me qëllim sigurimin e vazhdueshmërisë së punës, për të gjitha shërbimet e ofruara nga ky sistem.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve

Një tjetër projekt i spikatur për nga rëndësia e tij është edhe ***"Sistemi i Menaxhimit dhe Vrojtimit të Pyjeve"*** i realizuar nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, për të cilin gjithashtu AKSHI në bashkëpunim me ekspertët e institucionit, ka dhënë kontributin e tij në hartimin përfundimtar të termave të referencës duke mundësur bërjen efektive të fondit.
Sistemi i Menaxhimit dhe Vrojtimit të Pyjeve mundëson monitorimin e aktiviteteve të paligjshme të lëndëve drusore në pyje dhe identifikimin në kohë të zjarreve. Sistemi gjithashtu bën të mundur integrimin e funksionaliteteve GIS për gjeoreferencimin e pajisjeve regjistruese, të cilat mundësojnë fotografimin automatik dhe koordinat gjeografike të vendndodhjes së ngjarjes.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

AKSHI gjithashtu ka kontribuar në hartimin e Termave te Referencës së projektit me objekt ***"Upgrade i Storage dhe Migrimi i Sistemeve PCAMS, FMS"*** në bashkëpunim me ekspertët e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke mundësuar bërjen efektiv të fondit.
Objekti i këtij projekti ishte zëvendësimi i storage aktual që operonte në ISSH, me një storage të ri.
Sistemi do të ketë të dhënat për:

- PCAMS për Llogaritjen dhe Caktimin e Pensioneve

- FMS per Menaxhimin Financiar

Prokuroria e Përgjithshme

Një kontribut mjaft të rëndësishëm, AKSHI, në bashkëpunim me ekspertët e institucionit ka dhënë në hartimin përfundimtar të termave të referencës për projektin e realizuar nga Prokuroria e Përgjithshme me objekt ***"Sistemi Elektronik i Administrimit të Kërkesave për Verifikimin e Integritetit të Personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike"***.
Projekti synon të njësojë të gjitha informacionet ekzistuese dhe të integrojë sisteme të treta që do të ofrojnë një shërbim të saktë dhe të shpejtë, brenda afateve ligjore. Në këtë mënyrë, aplikimi do të marrë në shqyrtim të gjitha informacionet në lidhje me kërkesat për verifikim dhe gjenerimin në raporte dhe statistika sipas nevojave të institucionit dhe detyrimeve ligjore të Prokurorit të Përgjithshëm, për raportime në Kuvendin e Shqipërisë.

Qendra Kombëtare e Biznesit

AKSHI gjithashtu ka dhënë kontributin e tij për hartim përfundimtar të termave të referencës për projektin "***Krijimi i moduleve të reja dhe raportimeve për formularët e Bashkimit Ndërkufitar në sistemin e QKB dhe aplikimet online për Bashkimin Ndërkufitar dhe shërbimeve të tjera*"*.
Në kuadër të këtij projekti u ndërtuan aplikime online për disa shërbime të tjera ekzistuese në sistemin e brendshëm të QKB, gjithashtu u zhvilluan shërbime të reja si në sistemin e brendshëm dhe online të cilat janë kryesisht për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare, shërbime këto që nuk ofroheshin më përpara.

"Krijimi i portalit të QKB nëpërmjet integrimit dhe përmirësimit të portaleve ekzistuese", është një tjetër projekt ku AKSHI ka dhënë kontributin e tij në hartimin përfundimtar të termave të referencës.

Me anën e këtij projekti synohet që portali i QKR të përmirësohet dhe pasurohet me funksionalitetet e portalit të QKL, duke u transformuar në portalin e ri të Qendrës Kombëtare të Biznesit në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj bizneseve dhe rritjes së transparencës së institucionit ndaj publikut.

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Gjithashtu AKSHI në bashkëpunim me ekspertët e ZQRPP-së, ka dhënë një kontribut mjaft të rëndësishëm në hartimin përfundimtar të termave të referencës për projektin me objekt ***"Ndërtimi i sistemit Multifunksional për shërbimet që ofrohen në ZRPP".***

Ky projekt synon ndërtimin e një sistemi multifunksional dhe të qendërzuar të procedurave të rregjistrimit të pasurive të paluajtshme, i cili do të jetë i aksesueshëm nga individët, personat fizike apo juridike, dhe institucionet paralele të perfshira në procesin e vendimarrjes.
Gjithashtu synon përmirësimin e shërbimit për qytetarët në drejtim të lehtësimit të procedurave, për aplikime në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
Në këtë mënyrë do të bëhet shkëmbimi i informacionit midis:

- Individ-ZRPP/ZRPP-Biznes
- Institucione paralele-ZRPP/ZRPP-institucione paralele

6.3. Projekte të AKSHI-t për vitin 2016

Gjatë këtij viti, AKSHI ka zhvilluar një sërë projektesh, të cilat listohen në vijim:

1. "**Blerje shërbim Interneti i përqëndruar 350 Mbit/s",** brenda vitit 2016 - (Linja 1)
2. **"Blerje shërbim Interneti i përqendruar 350 Mbit/s**", brenda vitit 2016 - Linja nr. 2
3. **"Blerje shërbim Interneti i përqendruar 800 Mbit/s",** brenda vitit 2016 - Linja nr. 3

Duke u bazuar në standardet e përdorimit të internetit në administratën shtetërore (www.akshi.gov.al), duke marrë shkas nga rreziqet potenciale, rolin e agjencisë në forcimin e politikave dhe përfitimin ekonomik, si dhe duke përdorur infrastrukturën e tij të rrjetit, AKSHI do bëjë të mundur ofrimin e shërbimit të internetit për një pjesë të konsiderueshme të institucioneve qendrore të vendit, duke u kthyer kështu në një nyje të vetme aksesi interneti për qeverinë qendrore.

Infrastruktura Core që disponon AKSHI, krijon një siguri të lartë dhe ka nivel të mirë përcaktuar në përftimin e shërbimit të Internetit, në krahasim kjo me infrastrukturën e institucioneve të tjera qeveritare, të cilat kanë përfituar internet deri tani nga ISP të ndryshme dhe janë të ndërtuara në parime tepër të thjeshta të konfigurimit të rrjeteve.

Në të njëjtën kohë, investimet në fushën e sigurisë për mbrojtjen nga rreziqet që vijnë nga Interneti bëhen vetëm një herë dhe në një pikë të vetme duke kursyer investimet për çdo institucion.

Një aspekt shumë i rëndësishëm është aspekti ekonomik, pasi prokurimi me bandwidth të gjerë është ekonomikisht më i favorshëm se sa kryerja e shumë prokurimeve me bandwidth të ulët.

Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka përdorimi i internetit jo vetëm si mjet informimi, por edhe si infrastrukturë komunikimi midis entiteteve qendrore me ato lokale është parë e arsyeshme që shërbimi i internetit të trajtohet si shërbim kritik. Pra, lidhjet të bëhen në mënyrë redundante (High Available) për të siguruar një shërbim të vazhdueshëm dhe cilësor 24 orë / 24 orë në 7 ditë të javës.

4. **"Rikonceptim i Zyrave të AKSHI-t (faza 2)".** Punimet e ndërtimit konsistojnë në Punime të Brendshme për riparimin dhe rikonceptimin e zyrave të institucionit dhe përmbajnë kryesisht punime instalimi, punime kartonxhes etj.
   Referuar:
   - përmirësimit të kushteve të punës në ambientet e AKSHI-t
   - unifikimit të sipërfaqes së zyrave me ambientin shtesë
   - aplikimit të arkitekturës bashkëkohore për mënyrën e funksionimit të zyrave të institucionit.

5. **"Rritja e Sigurisë fizike dhe dixhitale në shkollat e arsimit të mesëm, ndërtimi i platformës multidimensionale të komunikimit".**
   Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është rritja e sigurisë fizike dhe dixhitale në shkolla të arsimit të mesëm dhe ndërtimi i platformës multidimensionale të komunikimit. Objekt i këtij projekti janë shkollat e mesme dhe laboratoret ICT, në mbështjetje të platformës e-learning.

Projekti synon të rrisë cilësinë në mësimdhënie duke rritur prezencën e kontributin e Teknologjisë së Informacionit në shkollat e mesme, në përputhje të plotë me politikat e qeverisë në projektet TIK, Axhendës Dixhitale 2014-2020 dhe strategjinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Strategjia e Zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020"

6. "Arkiva elektronike për sistemin e dokumentit elektronik për ministritë e linjës".

Objektivi kryesor i këtij projekti është realizimi i një zgjidhje të qëndrueshme për të mundësuar ruajtjen dhe arkivimin elektronik të të dhënave të sistemeve elektronike të përqendruara në Qendrën e të Dhënave Qeveritare. Gjithashtu objektiv i projektit është edhe kryerja e konfigurimeve përkatëse për të migruar sistemin EDRMS, e-Aktet, e-tracking dhe e-Leje në këtë sistem të ri ruajtje dhe arkivimi.

Krijimi i një sistemi elektronik të qendërzuar, ruajtjeje dhe arkivimi për sistemet elektronike ekzistuese do të sillte:

- Reduktim të kostove për implementime te Back-up-it apo arkivimit të dedikuar për secilin sistem
- Reduktim të hapësirave për back-up-e për secilin sistem
- Lehtësim në menaxhim dhe mirëmbajtje teknike

Qëllimi kryesor i këtij projekti është ndërtimi i një sistemi ruajtje qendrore elektronike për sigurimin e kapaciteteve dhe kushteve optimale që do të shërbejnë për të krijuar një depozitim qendror të të dhënave për sisteme elektronike të përqëndruara në Qendrën e të Dhënave Qeveritare (jo vetëm sistemet e përfshira në këtë projekt), si edhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme për të migruar sistemet ERDMS, e-Aktet, e-tracking dhe e-Lejet në këtë sistem të ri ruajtje dhe arkivimi.

7. "Konfigurimi i pajisjeve për nënshkrimin elektronik në institucionet shtetërore në kuadër të projektit E- Leje" .

Objektivi i procedurës së prokurimit është:

- Konfigurimi i pajisjeve USB-Token për nënshkrimin elektronik.
- Instalimi i software-it përkatës për leximin e të dhënave në USB Token për Institucionet përkatëse në rang republike.

8. "Sistemi i integruar i monitorimit të menaxhimit të kontrollit të cilësisë"

Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi i sistemit të integruar të monitorimit të manaxhimit të kontrollit të cilësisë, i cili duhet të përmbushë objektivat e mëposhtme:

- Të reduktojë pasigurinë që ka të bëjë me përpunimin dhe përdorimin e të dhënave massive (big data), duke ofruar një platformë të plotë dhe efektive të dhënash për vendimmarrësit.
- Të ulë marzhin e gabimeve në analizën e të dhënave masive (big data) duke udhëzuar përdoruesit për rrugën e duhur.
- Të ndihmojë vendimmarrësit të marrin vendimet e duhura bazuar në të dhëna dhe analiza të menaxhimit të cilësisë (Managing Total Quality/MTQ).
- Të përmiresojë menaxhimin e kontrollit dhe cilësisë së përgjithshme të planeve operacionale të punës në mënyrë të tillë që të arrihet një shkallë më e lartë eficence gjatë zbatimit të tyre.

- Të përmirësojë menaxhimin dhe kontrollin e përgjithshëm të cilësisë së politikëbërjes së nivelit të lartë për të paktën tre çështje specifike.

  Qeveria shqiptare ka për qëllim të përmirësojë menaxhimin në vështrim të kontrollit dhe cilësisë së përgjithshme, (përmbushjes në kohë të detyrave, rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në vendimarrje, si dhe planifikimi më të mirë të punës), nëpërmjet zhvillimit të një sistemi të sofistikuar analitik, qe mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat e sistemeve në infrastrukturën aktuale të menaxhimit dhe monitorimit te aktivitetit qeveritar në kuadrin e miradministrimit publik.

9. "Upgrade i Sistemit të UPS të Datacenterit Qeveritar"

Qëllimi i këtij shërbimi, është mundësimi i një kontrate për përmirësim të sistemit UPS për furnizimin të pandërprerë me energji për dhomën e serverave 1 si dhe furnizimin e pjesëve të nevojshme të konsumit për UPS-të ekzistues.

Për të kryer shërbimet në UPS-të ekzistues tek dhoma e SR1 rrezikohet ngarkesa pasi ngarkesa aktuale është 90 KVA dhe me shtimin e pajisjeve ose serverave ne Rak sjell një rritje të ngarkesës. Instalimet elektrike që do të kryhen duhet të jenë konform instalimeve të "Rregullores për ndërtimin e dhomës serverave" të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

7. Drejtoria e Sigurisë e-Gov

Drejtoria e Sigurisë e-Gov ka si objektiv të saj ofrimin dhe mbikëqyrjen e standardeve të sigurisë së informacionit për infrastrukturën që AKSHI administron. Gjithashtu ajo është përgjegjëse mbi administrimin e platformës PKI, për infrastrukturën e Çelësave Elektronikë Publikë dhe për ofrimin e shërbimeve që kjo infrastrukturë ofron. Vlerëson dhe udhëzon përgatitjen dhe implementimet e sistemeve qeveritare me qëllimin rritjen e sigurisë së informacionit në një nivel të pranueshëm.

Në zbatim të Ligjeve, VKM, Rregulloreve dhe Standardeve të miratuara rekomandon dhe mbikëqyr marrjen e masave për të garantuar disponueshmërinë, konfidencialitetin, integritetin, si dhe mundësitë e auditimit të sistemeve e-Gov të administruara nga AKSHI;
Përgatit strategjinë e sigurisë së informacionit e- Gov në mbështetje të objektivave të AKSHI-it;
Ndërton dhe përditëson politikat e sigurisë së informacionit e-Gov të cilat mbështesin objektivat e AKSHI-it;
Identifikon dhe menaxhon risqet e sigurisë se informacionit dhe zhvillon procese për menaxhimin e riskut për përcaktimin, analizimin dhe zvogëlimin e tij;
Mbikëqyr që masat e marra për zvogëlimin e riskut janë marrë parasysh në përgatitjen e projekteve dhe gjatë implementimit të tyre;
Realizon vlerësime të sigurisë së informacionit për sistemet dhe infrastrukturën e-Gov.

Drejtoria e Sigurisë e-Gov përbehet nga dy sektorë:

- Sektori i Sigurisë së Informacionit
- Sektori i Infrastrukturës së Çelësave Publikë

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), bazuar në vendimin Nr. 703, datë 29.10.2014, PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT është autoriteti përgjegjës, i cili zhvillon dhe ofron shërbimet e përqendruara për administratën shqiptare duke arritur në ofrimin e disa shërbimeve për institucionet qeveritare si:

I. Ofron shërbimet e përqendruara të TIK-ut për administratën publike, përfshirë shërbimet e autentifikimit dhe nënshkrimit elektronik.

Shërbimet e përqendruara ndër të tjera përfshijnë

- Postën elektronike qeveritare, (Gov mail);
- Internet të sigurt;
- DNS të sigurtë (Domain Name System);
- Shërbimet Hosting për sisteme, pajisje, aplikime, faqe/portale web etj.;
- "Government Cloud", në të cilën janë hostuar shërbimet e ndryshme elektronike për vetë administratën të cilat janë në shërbim të qytetarit dhe biznesit.

II. Zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike, e cila përbëhet nga:

- Portali unik qeveritar e-Albania, platforma qeveritare e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, sipas tipologjisë: qeveri - qeveri, qeveri - qytetar, qeveri - biznes;
- Regjistri Kombëtar i Shërbimeve Qeveritare online;
- Regjistri Kombëtar i Bazave të të Dhënave Shtetërore;
- Qendra e të Dhënave Qeveritare (Datacenter-in qeveritar);
- Qendra e rivendosjes dhe/ose vazhdueshmërisë së punës së datacenter-it qeveritar, në rast fatkeqësie (Disaster Recovery Center);

Qendra e të Dhënave Qeveritare pranë AKSHI ka një numër të konsiderueshëm paisjesh, sistemesh, databazash dhe aplikacionesh.

Rrjeti qeveritar GovNET aktualisht është sistemi i cili garanton të gjitha shërbimet e përqendruara. Për këtë arsye është shumë e nevojshme që të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Disponueshmeria – pra të jetë në funksion 24/7 në çdo moment;
b) Të jetë i sigurt – të plotësojë një sërë standardesh të sigurisë;
c) Identifikimi i pajisjeve që bëjnë pjesë në këtë rrjet;
d) Autentifikimi i tyre në qendër;
e) Kriptimi i trafikut nga institucionet drejt qendrës dhe nga institucioni në institucion;
f) Monitorimi i gjendjes teknike të pajisjeve;
g) Monitorimi i parametrave cilësorë dhe sasior të rrjetit në kohë reale;
h) Dublimi i pajisjeve kritike dhe evitimi i "Single Point of Failure";
i) Të jetë i monitorueshëm – të ndërtohet platforma e monitorimit fizik të pjesëve përbërëse të rrjetit në kuptim të parametrave fizikë të pajisjeve dhe atyre të punës. Të evidentohen çdo ndryshim fizik apo logjik i statusit të pajisjeve dhe pjesëve përbërëse të rrjetit;
j) Të jetë i shkallëzueshëm në terma gjerësie bande/ përdorues. Të mundësohet në mënyrë të përqendruar përcaktimi i bandës në nivel përdoruesi nga administratori i rrjetit;

k) Të jetë i menaxhueshëm në kuptimin e defekteve dhe përballimit të tyre. Është e domosdoshme që e gjithë platforma e rrjetit që nga niveli fizik e deri në nivel aplikacioni të monitorohet nga qendra e kontrollit gjeografikisht e pozicionuar në Tiranë. Gjithashtu të gjitha veprimet e tjera që kanë lidhje me menaxhimin e përdoruesve apo të pajisjeve qendrore apo fundore të kryhen në mënyrë efikase dhe të menjëhershme në rast problematikash teknike, ndryshimeve të konfigurimeve ose thyerjes së sigurisë.

Arkitektura aktuale e rrjetit është mjaft e komplikuar dhe numri i institucioneve të lidhura në GovNET është gjithmonë e në ngritje. Aktualisht në GovNET janë të lidhura 220 institucione. GovNET në formë skematike është i përbërë konceptualisht nga tre nivele:

1. Core Network
2. Distribuition Network
3. Access Layer

Figura 1 - Nivelet e rrjetit GovNET

Niveli i parë është zemra e rrjetit i cili menaxhon funksionet e SWITCHING, ROUTING, SECURITY MANAGEMENT. E gjithë infrastruktura Core e rrjetit është e përberë nga pajisje CISCO të modeleve të ndryshme.
Tashmë AKSHI nëpërmjet GovNET ofron shërbime parësore për institucionet qeveritare, si mail, menaxhim qendror të përdoruesve, internet, garanton përditësimin e terminaleve dhe serverëve "site", menaxhon infrastrukturë virtuale duke u bazuar në zgjidhjet "Government Cloud Service", etj .

Duke kaluar në një infrastrukturë të përqendruar kërkesat për shërbime rriten në vazhdimësi si pasojë e kërkesave të institucioneve dhe rritjes së numrit të përdoruesve.

Gjithashtu duke u bazuar në standardet e përdorimit të internetit në administratën shtetërore (www.akshi.gov.al), si dhe duke marrë shkas nga rreziqet potenciale, rolin e Agjencisë në forcimin

e politikave dhe përfitimin ekonomik, AKSHI duke përdorur infrastrukturën e tij të rrjetit bën të mundur ofrimin e shërbimit të internetit për një pjesë të konsiderueshme të institucioneve qendrore të vendit duke u kthyer kështu në një nyje të vetme aksesi interneti për qeverinë qendrore. E gjithë kjo duke pasur parasysh infrastrukturën Core që AKSHI disponon, e cila krijon një siguri të lartë dhe në nivele të mirëpërcaktuara në përftimin e shërbimit të internetit, dhe se në përgjithësi infrastruktura e institucioneve të tjera qeveritare të cilat kanë përfituar internet deri tani nga ISP të ndryshme ka qenë ndërtuar në parime tepër të thjeshta të një Network-u bazik.
Në të njëjtën kohë investimet në fushën e sigurisë për mbrojtjen nga rreziqet qe vijnë nga interneti bëhen vetëm një herë dhe në një pikë të vetme duke kursyer investimet në çdo institucion.
Në vitin 2014, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ndërmori për herë të parë një investim shumë të rëndësishëm me qëllim rritjen e sigurisë në rrjetin qeveritar GovNET dhe Qendrën e të Dhënave Qeveritare si më poshtë vijon:

- Web Security, Mail Protection;
- Zgjidhje Për Manaxhimin Dhe Optimizimin e Trafikut të Internetit;
- Platforma e Lëvrimit të Aplikimeve;
- Firewall dhe VPN Concetrator;
- Sistem për informacionin e sigurisë dhe menaxhimit të ngjarjeve.

Në vijim të investimeve madhore gjatë vitit 2014 për rritjen e sigurisë në qendrën qeveritare të të dhënave, rrjetin qeveritar GovNET dhe shërbimeve të përqendruara për administratën publike në nivel qendror gjatë vitit 2015 vazhdoi përforcimi i sistemeve të sigurisë:

a) Vendosja e një sistemi mbrojtës të sofistikuar në çdo pajise fundore dhe server për të rritur mbrojtjen nga rreziqet dhe sulmet kibernetike.
b) Enkriptimi i rrjetit Gov-Net për të gjitha linjat data, midis AKSHI-t, ministrive dhe institucioneve të rëndësisë së veçantë si:
    - Kryeministria
    - Ministria e Mbrojtjes
    - Ministria e Punëve të Brendshme
    - Ministria e Drejtësisë
    - Ministria e Punëve të Jashtme
    - Ministria e Financave
    - Shërbimi Informativ i Shtetit
    - Drejtoria e Sigurimit te Informacionit te Klasifikuar
    - Prokuroria e Përgjithshme
    - Drejtoria e Parandalimit, Pastrimit të Parave
    - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
    - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
    - Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
    - Agjencia e Prokurimit Publik
    - Insituti i Sigurimeve Shoqërore
    - Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetsor
    - Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor
    - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Krijimi i një arkitekture me disponueshmëri të lartë (eng. High Availability) për sistemin aktual Firewall në nivelin e aplikacioneve Web (eng. Web Application Firewall).

- Rritja e kapacitetit e sistemit të menaxhimit të ngjarjeve (SIEM) duke përfshirë në të gjithë infrastrukturën e rrjetit GovNET: Firewall, router, switch dhe servera.

Shërbimet e mësipërme i janë vënë në dispozicion të gjithë administratës e-Gov për të pasur:

- Disponueshmëri të lartë për të gjitha sistemet e sigurisë;
- Komunikimi të sigurt, bazuar në protokollet më të sigurta të enkriptimit, duke ofruar disponueshmëri dhe performancë të lartë të transmetimit të informacionit.

Infrastruktura e sigurisë është e përbërë nga bashkërendimi dhe bashkëveprimi i disa sistemeve të cilat mundësojnë monitorim, analizim, bllokim/lejim, enkriptim dhe ruajnë informacionin, i cili shkëmbehet ndërmjet institucioneve të cilat bëjnë pjesë në e-Gov.

7.1. Infrastruktura e Çelësit Publik, PKI

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.703, date 29.10.2014, "Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", nenit 19, ligjit nr. 9980, datë 25.02.2008 "Për Nënshkrimin Elektronik" si dhe referuar ligjit 107/2015 për "Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara" Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit administron dhe mirëmban Infrastrukturën Qeveritare të Çelësit Publik (PKI) duke lëshuar certifikata të kualifikuara për nënshkrimin elektronik X.509 v3 për administratën publike dhe subjektet private ne kuader te sistemit te ri elektronik e-Leje te ngritur kohet e fundit ne Republiken e Shqiperisë.

Infrastruktura e Celesit Publik është bashkësia e të gjitha organizatave, sistemeve(hardëare, softëare),proceseve dhe politikave të sigurisë dhe marrëveshjeve, të cilat mundësojnë funksionimin e teknologjisë me celesa publike për një numer të caktuar përdoruesish.

Katër objektivat kryesore të Infrastrukturës Qeveritare të Çelësit Publik janë:

- Integritet
- Konfidencialitet
- Autentifikim
- Mos-Refuzim

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është certifikuar nga Autoriteti Kombetar për Certifikimin Elektronik si **Ofruesi i Kualifikuar për Shërbimet e Besuara (OKSHB).**

Detyrat Kryesore të Sektorit PKI janë:

- Monitorimet teknike lidhur me vulën kohore (TSA) dhe vlefshmërise së certifikatave ne kohë reale
- Raportimet tek Autoriteti Kombetar për Certifikimin Elektronik
- Update-s të RootCa dhe Subca dhe publikimet e tyre në faqen e AKSHIT-t
- Gjenerimet/Revokimet e certifikatave të kualifikuara
- Rifreskimet e Certifikatave të Sigurise dhe Deklaratave të Praktikave te Certifikimit si dhe publikimin e tyre në faqen e AKSHI-t.

- Kryerja e back-ups cdo 3 muaj për një sistem me të mbrojtur

Aktualisht AKSHI ka të ngritur Infrastrukturën qeveritare të Celesit Publik në përputhje me Politikat e Certifikimit dhe Deklaratës se Praktikave. Arkitektura e Infrastrukturës me Celës Publik e AKSHI-t është në formë hierarike e ndare ne 3 nivele (Figura 1).

- Niveli i pare /ROOT CA.
- Nivelit i 2 /Sub CA
- Niveli i 3 / Class.

Certifikata Bazë e AKSHI-t është ROOTCA e cila është një certifikatë besuese per gjithe arkitekturën e saj. Ajo është tashmë e publikuar në faqen zyrtare të AKSHI-t: www.akshi.gov.al/pki.



Figura 1. Arkitektura hirearkike PKI AKSHI

Një certifikatë e kualifikuar për nënshkrimin elektronik në një dokument elektronik bazuar në PKI siguron integritet,siguri dhe konfidencialitet.

PKI e AKSHI-t përdor kriptografinë e çelësave publike, e cila siguron një nivel sigurie të lartë për ruajtjen dhe transmetimin informacioneve dhe të dhënave.

Në **Shkurt** të vitit 2016 në kuadër të mirëfunksionimit dhe gadishmërisë së sistemit për gjenerimin e certifikatave të kualifikuara, lindi nevoja për një rigjenerim të Certifikates ROOTCA AKSHI dhe klasave te tij respektive, e cila perfundoi me sukses.

Ne **Mars** te vitit 2016 AKSHI në një bashkëpunim ndër-institucional me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit gjeneroi certifikata të nenshkrimit elektronik për 61 bashki të njesisë qendrore të Republikës së Shqipërisë.

AKSHI ka kryer gjithashtu bashkëpunime me institucione të tjera siç janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës,
- Ministritë,
- Drejtoria e Policisë së Shtetit,
- Fondi i Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor

Gjate një periudhe 4-mujore (Prill-Gusht) AKSHI zhvilloi trajnime per Administraten Publike për funksionimin dhe përdorimin e nënshkrimit elektronik.
Platforma PKI është funskionale jo vetëm për Administratën Publike, por dhe për subjektet private, të cilat i japin një numër të madh përdoruesish të nënshkrimit elektronik.

Për shkak të numrit të madh të gjenerimeve të nënshkrimit elektronik dhe për t'u ardhur në ndihmë nënpunësve apo qytetarëve për çdo problem që mund të kenë gjatë përdorimit apo konfigurimit të certifikatës së nënshkrimit elektronik, AKSHI ka mundësuar një e-mail zyrtar: pki.akshi.gov.al.

Gjatë vitit 2016, AKSHI si OKSHB ka lëshuar **1700** certifikata të kualifikuara për nënshkrimin elektronik përkatësisht si më poshtë:

- **1000** certifikata per Administratën Publike
- **700** certifikata per aktorët e përfshire në projektin e-Leje

Janë revokuar 54 certifikata të nënshkrimit elektronik.

AKSHI si OKSHB per vitin 2016 ka raportuar tek Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik:

- Raportet 3-mujore mbi numrin e lëshimit të certifikatave të nënshkrimit elektronik dhe revokimet e tyre;
- Raportin vjetor mbi personelin përgjegjës të infrastrukturës PKI dhe numrin total të certifikatave të lëshuara për periudhën Mars2015-Mars2016;
- Raportimet mujore për certifikatat e kualifikuara për ZOS.
- Informim mbi rigjenerimin e ROOTCA dhe 4 Klasave te AKSHI-t
- Raportimin mbi ndërtimin e një tjeter SUBCA, në një bashkëpunim ndërmjet AKSHI-t- Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)

7.2. Platforma e Sistemit të Menaxhimit të Ngjarjeve

Pranë AKSHI-t është implementuar Platforma e Sistemit të Menaxhimit të Ngjarjeve (System Information Event Manager), Menaxhues Logesh, i cili është një sistem i integruar për menaxhimin e logeve dhe analizës në kohë reale të ngjarjeve të sigurisë (SIEM). Sistemi garanton që informacioni i sigurisë dhe ngjarjet e gjeneruara vazhdimisht, janë të ruajtura, të monitoruara të analizuara dhe raportuara në kohë reale. Sistemi mbledh loge nga pajisje të ndryshme të rrjetit (WAF, Fortinet, Checkpoint, Webserver etj).

Your environment generates: **181528** events per seconds

Figura 2 - Statistika të eventeve të gjeneruara nga sistemet që monitorohen në SIEM në sekondë.

Sistemi i menaxhimit të ngjarjeve siguron një regjistër të plotë të aktiviteteve të rrjetit, si dhe raportim sa më gjithëpërfshirës, të integrueshëm dhe të personalizueshëm. SIEM gjithashtu, mban dhe ruan rekorde të plota të logeve, në mënyrë që investigimet dhe raportimet sipas standardeve të sigurisë, të kryhen sa më lehtë.

Number of connections per Protocol - Checkpoint

service	allowed	blocked	Total
domain-udp	77451114	15723903	93175017
http	47730180	1168623	48898803
https	27756640	3789624	31546264
telnet	10984945	9426358	20411303
smtp	5751795	622868	6374663
6666	529	3371062	3371591
7547	1485064	1200290	2685354
ident	1951992	2253	1954245
snmp-read	378401	1267081	1645482
2323	721547	595486	1317033

Figura 3 - Paraqitje grafike e lidhjeve per cdo protokoll në Firewall gjatë 1 muaji.

Gjatë vitit 2016 janë shtuar shërbimet si dhe burimet nga ku merren loge në kohë reale, ku u përfshin Core Firewall, Firewall në nivelin e aplikacioneve Web, si dhe Apache të platformës ku hostohen faqet qeveritare për të pasur dhe analizuar të gjithë informacionit e veprimeve dhe ndryshimeve që bëhen në këto sisteme në mënyre që të ofrojmë një pasqyrë më të saktë të të gjithë veprimeve dhe për të marrë masa në kohë reale për rritjen e sigurisë në këto sisteme

7.3. Siguria e faqeve të internetit të institucioneve zyrtare

Me anë të kësaj infrastrukture, AKSHI ka ngritur një sistem të integruar për të kompletuar dhe përditësuar politikat e sigurisë dhe të mbrojtjes të faqeve zyrtare të internetit, si dhe identifikimet e sulmeve më të fundit (eng. signatures).
Mbrojtje të aksesit në faqet zyrtare të institucioneve të cilat hostohen në AKSHI (si ato të hostuara në cloud publik ashtu edhe ato në server fizik)
Sistemi është në gjendje të mbrojë nga sulme të shkallës së gjerë, si edhe sulme të automatizuara, si për shembull: burime sulmesh, bot, phishing URL, si dhe teknologji intuitive në mënyrë që të bllokojë IP-të keqbërëse përpara se të kryhet një sulm.



Figura 4 - Mbrojtja e sulmeve në 24 orë

Firewall në nivelin e aplikacioneve Web mundëson një teknologji për identifikimet gjeologjike të IP-ve që kryejnë aktivitet keqdashës në mënyrë që të krijohet një pasqyrë më e qartë për identifikimin, parandalimin, dhe marrjen e masave ndaj këtyre sulmeve. WAF kryen bllokimin e sulmeve DoS si në shtresën e aplikimeve ashtu edhe në atë të rrjetit. Gjithashtu mundëson teknologji për raportim në kohë reale, raportim të detajuar, si dhe një sistem monitorimi në kohë reale të gjithë aktiviteteve dhe menaxhimit të politikave të WAF si dhe sigurisë së faqeve Web që ajo mbron.

Figura 5 - Paraqitje gjeografike e sulmeve të kryera në 24 orë.

Gjatë vitit 2015 u mundësua vendosja e WAF aktual në një cluster për të ofruar disponueshmëri të lartë dhe mos ndërprerje të shërbimit të Web Appliacion Fireëall, nga i cili mbrohen faqet qeveritare të hostuara në AKSHI.

WAF mbron në mënyre pro aktive nga mënyra tradicionale dhe të reja në hakimin e faqeve web duke përfshirë këtu: SQL Injection, Cross Site Scripting, Cookie Injection etj.



Figura 6 - Paraqitja grafike e alerteve në 24 orë

7.4. Siguria e aksesit në internet të institucioneve

Siguria e aksesit të Web ofron shërbime të tilla si: URL filtering/Parental control, Anti-virus, anti-spyware për HTTP, Anti-phishing, Firewall dhe application firewall duhet të detektojnë VoIP dhe aplikacione p2p, Raportime.
Sistemi është i vendosur në Bridge Mode për t'u lidhur me profilin e duhur të përdoruesit është integruar me Active Directory.
Sistemi ofron një ndërfaqe web të centralizuar nga e cila menaxhohen të gjitha shërbimet. Gjithashtu bën të mundur që çdo institucion të mund të menaxhojë pjesën e tij të përdoruesve dhe aksesin në internet.
Shërbimi i filtrimit të shfletimit në internet (eng. Web Filtering) bën të mundur filtrimin e përmbajtjeve që mund të aksesohen në internet. Është i ndarë në 60 kategori paraprake, të cilat rifreskohen çdo ditë me 'whitelist' dhe 'blacklist' të URL-ve të ndryshme. Siguria e ofruar në këtë zgjidhje është në aplikacionet në protokoll HTTP, HTTPS, FTP dhe SMTP. Moduli i raportit ofron raporte të personalizuar dhe të detajuara për çdo shërbim të ofruar.

7.5. Siguria e postës elektronike zyrtare

Për të pasur një komunikim zyrtar sa më të sigurtë midis institucioneve qeveritare të rrjetit GovNET është implementuar një platformë, e cila filtron dhe inspekton bllokon/lejon e-mail-et zyrtare për Spam ose me përmbajtje jo të lejueshme, të cilat mund të përbejnë rrezik për sigurinë e sistemeve e-Gov.
Sistemi ofron ndërfaqe të qendërzuar në të cilën menaxhohen të gjitha shërbimet që kanë për detyrë ofrimin e e-mail-eve zyrtare sa me të sigurta.
Sistemi është i konfiguruar për t'u lidhur me profilin e duhur të përdoruesit është integruar me Active Directory.

7.6. Menaxhim dhe Optimizim i Trafikut në Internet, inspektim me imtësi të paketave (DPI)

Menaxhim dhe Optimizim i Trafikut në Internet, inspektim me imtësi të paketave (eng. Deep Packet Inspection) është e implementuar në cluster dhe disponueshmeri të lartë në mënyrë që të bëjë të mundur aplikimin e politikave dhe vazhdim të shërbimeve edhe në rast se një nga nyjet/pajisjet bie. Pajisjet janë të montuara në bridge mode. Ky sistem bën të mundur optimizimin e rrjetit në nivel IP dhe në nivel Aplikacioni. Sistemi bën të mundur edhe filtrimin e aplikacioneve të ndryshme jo thelbësore për institucionin të cilat konsumojnë bandwith të tepërt (shembull: Torrent, TeamViewer, IRC etj). Sistemi mundëson edhe raportime në kohë reale ose periodike në formate të ndryshme dhe të personalizuar sipas nevojës.

7.7. Platforma e lëvrimit të aplikimeve

Platforma ofron funksionalitete si më poshtë: Application Delivery, Application Security, Reverse Proxy, Load Balancing. Zgjidhja është e implementuar në HA mode / Cluster. Zgjidhja ofron krijimin e instancave virtuale duke ofruar funksionalitetet e sipërpermendura në mënyrë të izoluar. Zgjidhja ofron një siguri mbrojtje nga DoS në nivel aplikimi, si dhe integrated security attack mitigation. Duke mundësuar mbrojtje nga DoS dhe nga mbingarkim të kërkesave të panevojshme për aplikacionet bën të mundur optimizimin e performancës se aplikacioneve, pra, jo vetëm monitorimin nëse aplikacioni apo serveri ku është implementuar aplikacioni është në punë ose jo. Si të gjitha sistemet e tjera edhe këtu është i përfshirë moduli i raportimit të personalizuar, si në kohë reale ashtu edhe periodikisht.

7.8. Firewall dhe VPN

Pajisjet firewall bëjnë të mundur kontrollin e aksesit për klientë, server, aplikime, pajisje rrjeti dhe protokolle komunikimi. Njohje në nivel user-i apo makinë për një definim granular të politikave të sigurise për user dhe group user-ash. Network Address Translation (NAT): NAT Bridge Mode: Routed Mode. Zgjidhja ofron lejimin e aksesit nga interneti për shërbimet e brendshme në mënyrë të sigurtë (VPN) si: Site-to-Site Virtual Private Network, Multiple Remote Access VPN Connectivity Modes: Software IPsec VPN ofron zgjidhje me VPN në mënyra dhe kategorizime të ndryshme, si dhe krijimin e tuneleve VPN bazuar në domain user-ash. Remote Access behet me anë të enkriptimit SSL VPN me teknologji SSL VPN për komunikime të sigurta dhe të enkriptuara nga PC, Laptop, Tablets dhe Smart Phones.

Funksionalitete të plota Intrusion Prevention System (IPS): një shërbim IPS të plotë me funksione konstante update-imi dhe definicionesh të reja. Mbrojtje në kohë reale: Përditësim për dobësi (vulnerabilitete) të klientët dhe server-at, Exploits, Protocol misuse, Outbound malëare communications, Tunneling attempts, Application control, Sulme të përgjithshme pa signature të paracaktuara. DoS Mitigation Engine: funksionalitet i shtuar kundër DoS attacks. Multi-Method Detection Engine: Vulnerability and exploit signatures, Protocol validation, Anomaly detection, Behavior-based detection, Multi-element correlation. Inspektim të trafikut të enkriptuar SSL.

7.9. Sistemi mbrojtës Antivirus i Qendërzuar

Është zëvendësuar zgjidhja e vjetër jo efikase e Microsoft Forefront Security, e cila kishte një nivel sigurie shumë bazik i cili anashkalohej lehtësisht nga programe malware.

Në vend të tij është vendosur Symantec Endpoint Protection, me një instalim të qendërzuar, i cili është integruar me Active Directory të AKSHI si dhe me disa A.D/Ldap të institucioneve të tjera që e kanë një domain të tyren të pavarur nga AKSHI.
Ky sistem solli neutralizimin e shumë viruseve, të cilët kanë qenë të instaluar nëpër kompjuterat e punonjësve të institucioneve të ndryshme dhe krijonin probleme të ndryshme, si në komunikim ashtu edhe në performancën e pajisjeve të tyre.
Sistemi i ri i instaluar përfshin desktop firewall, mbrojtje edhe për pajisjet Apple, të cilët janë pjesë e pajisjeve të administratës, por nuk kanë qenë të pajisur me antivirus më parë. Zgjidhja siguron mbrojtje proaktive edhe nga teknika të panjohura infektive, zbulim malware brenda dosjeve të kompresuara, mbrojtje në nivel rrjeti, kontroll i të gjithë pajisjeve periferike, bllokimin e ekzekutimit të të gjithë aplikacioneve të paautorizuara, si dhe asnjë nga përdoruesit e paautorizuar nuk mund të bëjë në asnjë mënyrë çaktivizimin e kësaj mbrojtje nga pajisjet ku është instaluar.

7.10. Aksesi Fizik në Qendrën e të Dhënave Qeveritare

Datacenter-i qeveritar ofron mjedise të qëndrueshme, me siguri të lartë, pajisje të veçanta për shuarje zjarri dhe alarmet, energji elektrike të pandërprerë (UPS dhe gjeneratorë), lidhje network me shpejtësi të lartë, si dhe karakteristika të tjera të kërkuara nga sistemet kritike të vendosura pranë këtij datacenter.
Pranë Qendrës së të Dhënave Qeveritare janë vendosur mjaft sisteme kritike të cilët bazohen në infrastruktura kompjuterike dhe rrjeti Enterprise. Aksesi është i kontrolluar për të mbrojtur resurset fizike dhe të dhënat nga përdorimi i paautorizuar, dëmtime aksidentale ose me qëllim të keq dhe vjedhje.
Aksesi në Datacenter jepet vetëm në rastet kur është e nevojshme.
Objektivat më të rëndësishëm në lidhje me sigurinë e informacioneve janë garantimi dhe mbrojtja e ***integritetit***, **e *disponueshmërisë*** dhe **e *konfidencialitetit***.
Aksesi në qendrën qeveritare të të dhënave ose ambiente të tjera të AKSHI është i kufizuar vetëm për personat e autorizuar.
Të gjitha pajisjet e AKSHI dhe të gjitha pajisjet e tjera kritike janë të mbrojtura fizikisht nga kërcënimet e sigurisë dhe nga rreziqet e mjedisit.

8. DREJTORIA E VAZHDIMËSISË SË PUNËS BCC, Backup & DRC

Drejtoria e Vazhdimësisë së Punës BCC, Backup&DRC është një drejtori e re e shtuar pranë AKSHI-t, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 703 datë 29.10.2014 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit', Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 710 datë 21.08.2013 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit", si edhe me miratimin e strukturës gjate vitit 2015 në zbatim të Urdhërit Nr. 59 datë 23.04.2015 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".

Kjo drejtori përfshin dy sektorë:

1. *Sektori i DRC*
2. *Sektori i BCC*

Pranë këtyre sektorëve ka specialistë të cilët administrojnë sistemet në AKSHI me qëllim njohjen, administrimin, menaxhimin e sistemeve dhe aseteve të nevojshme të një site Disaster Recovery, për procedurat e back-up dhe recovery nga back-up. Përveç mbështetjes teknike që stafi realizon ai është angazhuar vazhdimisht në projekte, rishikime, dhënie mendimi dhe hartime të Termave te Referencës.

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve të përqendruara, AKSHI ofron edhe shërbimin për Data Disaster Recovery (DRC), Vazhdimësinë e Punës (Business Continuity) dhe Ruajtjen e Informacionit (Back-up) si më poshtë vijon:

8.1. Shërbimi i Data Recovery për Exadata (Projektet) dhe Infrastruktura Ekzistuese

Gjatë vitit 2014 është ngritur pranë AKSHI-t sistemi për vazhdueshmërine e punës, rekuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për sistemet qeveritare i implementuar në Oracle Exadata, me qëllim ofrimin e këtij shërbimi IAAS, për institucionet e Administratës Publike, me siguri dhe performancë të lartë. Në këtë infrastrukturë hostohen sisteme me databaza në teknologji të ndryshme si Oracle, DB2, etj. Në përfundim të vitit 2014, gjatë vitit 2015 dhe 2016 është ofruar ky shërbim për:

Sistemi i regjistrimit dhe kontrollit të barnave

Ngritja e një sistemi për rekuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për Sistemin e Regjistrimit dhe Kontrollit të Barnave, te cilat mbështeten në teknologjinë Oracle Database; është realizuar përpos ngritjes së kësaj infrastrukture në përfundim të vitit 2014.

Sistemi i Menaxhimit të Kontributeve për ISSH-në

Ngritja e një sistemi për rekuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për Sistemin e Menaxhimit të Kontributeve për Institutin e Sigurimeve Shoqerore duke krijuar një instancë në Exadata.

Sistemin e Gjendjes Civile

Për shkak të domosdoshmërisë për disponueshmëri të lartë dhe ruajtjes së të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, gjatë vitit 2015 AKSHI ofroi këtë shërbim dhe për institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Ministrinë e Brendshme.

Infrastruktura Teknike e Sistemit të Thesarit.

Ngritja e një sistemi për rekuperimin nga fatkeqësia dhe vazhdimësine e punës për Infrastrukturën Teknike të Sistemit të Thesarit, shërbim i ofruar për Ministrinë e Financave.

Sistemi i Dixhitalizimit të Sistemit të Shërbimit të Provës

Ngritja e site-t primar për databazën e Sistemit të Shërbimit të Provës në kuader të Dixhitalizimit të regjistrit të dosjeve të të dënuarve.

Sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Ngritja e site-t DRC për databazën e Sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Ngritja e site-t BCC me RMAN për databazën e Sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Sistemi DMFAS i Ministrisë së Financave

Ngritja e një sistemi për 89azhdimësinë e punës për Infrastrukturën Teknike të Sistemit të DMFAS, shërbim i ofruar për Ministrinë e Financave.

Sistemi i e-ekzaminime

Ngritja e një baze të dhë dhënash për hostimin e Infrastrukturën Teknike të Sistemit të e-ekzaminime, shërbim i ofruar për Ministrinë e Shëndetësisë.

Sistemi i licencave

Ngritja e një baze të dhë dhënash për hostimin e Infrastrukturën Teknike të Sistemit të licencave të ndërtuesve, shërbim i ofruar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

Sistemi FMS i ISSH

Në kuadër të implementimit të projektit të Infrastrukturave të BCC për Sistemet Heterogjene, ku përfshihet implementimi i një site BCC për këtë infrastrukturë, është hostuar databaza e sistemit në Exadata.

Më poshtë një tabelë me të dhënat mbi institucionet dhe site:

Institucioni	**Sistemi**	**Tipi**
ISSH	Sistemi i menaxhimit të kontributeve	DRC
DPD	Sistemi i Doganave	DRC
DPD	Sistemi i Doganave	BCC
Ministria e Shëndetësisë	Sistemi i kontrollit të barnave	DRC

DSHP	Sistemi i Dixhitalizimit të sistemit të Provës	PRIMAR
MB - GJC	Sistemi i Gjendjes Civile	DRC
Ministria e Financave	Sistemi i Thesarit	DRC
Ministria e Financave	Sistemi DMFAS	BCC
Ministria e Shëndetësisë	Sistemi e-ekzaminime	PRIMAR
Ministria e Zhvillimit Urban	Sistemi i licencave	PRIMAR
ISSH	Sistemi Financial Management System	DRC/BCC

Tabela 1

8.2. Shërbimi i vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (back-up) për infrastukturat e sistemeve:

Të portalit qeveritar e-Albania

Ngritja e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (back-up) për infrastukturën e portalit qeveritar e-Albania në një site të ri në mënyrë që të ofrohet shërbimi pa ndërprerje dhe të parandalohet humbja ose shkatërrimi aksidental i të dhënave.

Të Platformës Qeveritare të Ndërveprimit

Ngritja e sistemit të vazhdueshmërise së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (back-up) për infrastukturën e Platformës Qeveritare të Ndërveprimit në një site të ri në mënyrë që të ofrohet shërbimi pa ndërprerje dhe të parandalohet humbja ose shkatërrimi aksidental i të dhënave.

Të infrastruktures se EDRMS

Ngritja e sistemit të vazhdueshmërise së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (back-up) për infrastukturën e sistemit te protokollit dhe komunikimit shkresor, në Kryeministri dhe Ministrite e linjës, i cili është në zgjerim edhe më tej për institucionet e tjera të cilat kanë kërkuar këtë sistem, në një site të ri në mënyrë që të ofrohet shërbimi pa ndërprerje dhe të parandalohet humbja ose shkatërrimi aksidental i të dhënave.



Figura 1. Grafiku i ecurisë së ofrimit të shërbimit

Të shërbimeve të përqendruara:

- e-aktet
- eLejet
- SCCM and FIM Protection Group
- SCOM 2012
- Skype for Bussines 2015
- Exchange & Active Directory

8.3. Dokumentimi i Procedurave për DRC dhe BCC

Hartim i planeve të rekuperimit nga fatkeqësia

- Exchange Disaster Recovery Plan – Një dokumentim i plotë i infrastrukturës së mail server-it qeveritar me qëllim perfshirjen e të gjithë skenareve për rikuperim nga fatkeqsia.
- Skype for Business Recovery Plan - Një dokumentim i plotë i infrastrukturës së Skype for Business, e cila është një infrastrukturë e re, me qëllim përfshirjen e të gjithë konfigurimeve ekzistuese, por dhe skenareve për rikuperim nga fatkeqsia.
- Procedurat për kryerjen e Back-up-eve të infrastrukturave ekzistuese të Cloud Privat, postës elektronike, etj.

Në kuadër të marrëveshjes me Microsoft është filluar puna për perdorimin e Microsoft Azure Subscription ne funksion të siteve të Disaster Recovery për ambientet e testimit apo të siteve publike.

Gjatë vitit 2016 stafi i Drejtorisë së Vazhdimësisë së punës BCC, Backup&DRC është trajnuar në teknologjitë Microsoft konkretisht:

- Configuring Windows Server 2012 Advanced Services
- Exchange Server Recovery Services Risk Assessment

- Active Directory Certificates Recovery Services Risk Assessment
- Azure Workshop

8.4. Aktivitete të tjera për vitin 2016

- Hartimi dhe negocimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet për dhënien e ndihmës, ofrimin e shërbimeve të përqendruara në fushën e Teknologjisë së Informacionit;
- Pjesëmarrja në grupe pune për zbatimin e projekteve të ndryshme, vecanërisht me fokus në dixhitalizim dhe ofrimin e shërbimeve online;
- Hartimi i shkresave të ndryshme për bashkëpunim ndërinstitucional, zgjidhje e çështjeve të ndryshme administrative për mbarëvajtjen e punëve të AKSHI-t;
- Pjesëmarrje në trajnime të zhvilluara nga AKSHI
- Detyra të tjera;
- Pjesëmarrja në workshop, konferenca të ndryshme, tavolina pune etj.

Lista e anekseve

Aneks 1.1: Infografik vjetor 2016




Portali
unik qeveritar
RAPORT VJETOR - 2016
E-ALBANIA
Më shumë se 5.3 milion vizita në portal vetëm gjatë vitit 2016
54.15% e përdoruesve të rinj janë meshkuj
6:26 minuta
koha që përdoruesi ka shpenzuar duke shfletuar portalin
45.85% e përdoruesve të rinj janë femra
Përdoruesit gjatë vitit 2016 të ndarë sipas grupmoshave
35
30
25
20
15
10
5
0
27.50
33.50
15.50
12.50
5.50
5.50
%
18-24
25-34
35-44
45-54
55-64
65+
Përdoruesit e rinj të regjistruar në portal deri në vitin 2016
80000
70000
60000
50000
40000
30000
20000
10000
0
49809
43333
76776
71703
Përdorues të rinj
Viti 2013
Viti 2014
Viti 2015
Viti 2016
Përdoruesit e rinj gjatë vitit 2016 të ndarë sipas profilit
96%
4%
Biznese (4%)
Qytetarë (96%)
Rrugëtimi i zhvillimit të portalit dhe Platformës qeveritare të Ndërveprimit
2012
Në nëntor/dhjetor 2012 u krijua portali V1.0 e-albania dhe Platforma Qeveritare e Ndërveprimit
2013
6 sisteme të lidhura, 14 shërbime të nivelit 3 dhe 4
2014
Portali i ri V2.0 dhe Platforma Qeveritare e Pagesave Elektronike ; 17 sisteme të lidhura, 22 shërbime G2G, 119 shërbime G2C, G2B të nivelit 3 dhe 4
2015
248 shërbime elektronike G2C, G2B të nivelit 3 dhe 4
37 sisteme të lidhura, 57 shërbime G2G
2016
465 shërbime elektronike G2B, G2C të nivelit 3 dhe 4
© 2016 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Aneks 1.2: Lista e shërbimeve elektronike deri në fund të vitit 2016 në portalin qeveritar e-Albania

Nr.	Institucioni ofrues	Emërtimi i shërbimit	Niveli i sofistikimit të shërbimit	Kategoria përfituese e shërbimit
1	Ministria e Financave	Lista e pagesave të kryera nga Degët e Thesarit	4	QytetarBiznesQeveritar
2	Ministria e Shëndetësisë	Receta ime elektronike (për qarkun e Durrësit)	4	Qytetar
3	Ministria e Shëndetësisë	Rekomandim i ri për konsultë tek mjeku specialist	4	Qytetar
4	Ministria e Shëndetësisë	Rekomandimet e mia të lëshuara nga mjeku i familjes	4	Qytetar
5	Ministria e Shëndetësisë	Rezervimi i takimit për kryerjen e CT-Scaner trupi pa kontrast	4	Qytetar
